# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5549
E shtunë, 11 gusht 2018
çmimi 0.40 €


## Delawie: Miqësia ShBA - Kosovë nuk do të ndryshojë

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BESNIK OSMANI FAQE 4-5



# Rekomandimet e Zyrës së Auditorit të merren më seriozisht

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka thënë se institucionet e vendit duhet të jenë më fleksibile sa i përket marrjes parasysh të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është e kënaqshme. Osmani ka theksuar se është e nevojshme të rritet fokusi në zbatimin e rekomandimeve, pasi kjo do të rezultonte me qeverisje të mirë dhe shërbime kualitative për qytetarët. Ai ka bërë me dije se arsyet për zbatim të ulët të rekomandimeve janë mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre. Osmani ka thënë se Kuvendi dhe Qeveria kanë dështuar të sigurojnë kushte për punë sa i përket akomodimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit

## Analistët: Bashkimi i Luginës me Kosovën, i pamundur

FAQE 3

Analistët politikë kanë mohuar mundësinë e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën përmes korrigjimit të kufirit me Serbinë. Teksa kanë komentuar idenë e presidenti Hashtim Thaçi për këtë çështje, Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo është e pamundur, duke shtuar se presidenti qëllimisht e ka ngritur këtë çështje përpara formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive






## Protestohet në Gjakovë për vrasjen e dyfishtë

Me pankartat "Mos shfajësoni fajtorët" dhe "Reagoni me kohë", shoqëria civile e Gjakovës, e përkrahur nga Rrjeti i Grave të Kosovës, të premten kanë marshuar prej Parkut të Qytetit deri tek Çarshia e Vogël për ta kundërshtuar vrasjen e gruas 40-vjeçare dhe vajzës së saj në Brekoc të Gjakovës

FAQE 6

## AKTUALE

**SHQIPTAR APO KOSOVAR?** F. 11



Shkruan: Jakup KRASNIQI

**DY KADETË TË FSK-SË DIPLOMOJNË NË BRITANI** F. 11

**36 AMERIKANË BETOHEN PËR PUNË VULLNETARE NË KOSOVË** F. 7

**LIDERËT SHTETËRORË KUJTOJNË "ABEJËN" DHE DËSHMORËT E TJERË** F. 6

## EKONOMI

**ÇMIMET E KONSUMIT DITOR, 1.2 PËR QIND MË TË LARTA SE VJET** F. 9

**NDAHEN 50 MIJË EURO PËR PASTRIMIN E LEPENCIT NGA AZBESTI** F. 9

## KULTURË

**DUA LIPËS I DHUROHET 'ÇELËSI I PRISHTINËS'** F. 14

## SPORT

**ADEMI: EJANI NË PËRURIMIN E STADIUMIT 'FADIL VOKRRI'** F. 18

**DISTRIA KRASNIQI FITON MEDALJEN E BRONZTË NË BUDAPEST** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Të shtëna në Vlorë, 8 të vdekur dhe 7 të plagosur



**Tiranë, 10 gusht**- 8 persona kanë humbur jetën nga të shtënat me armë zjarri në Vlorë në orët e vona pasditen e së premtes, ka raportuar policia.
Të shtënat kanë ndodhur në fshatin Resulaj, në Selenicë, ku raportohet edhe për disa të plagosur.
Ngjarja ka ndodhur rreth orës 18:00 gjatë një përplasje me armë dhe ende nuk dihen shkaqet. Dyshohet se viktimat janë pjesëtar të të njëjtit fis me mbiemrin Zykaj. Dyshohet se personi që ka qëlluar me armë zjarri ka probleme mendore dhe është 24 vjeç.

# Pazari Vuçiq-Thaçi mund të sjellë destabilizimin e Maqedonisë

Shqetësimi krijohet se pas shkëmbimeve mes Kosovës dhe Serbisë, gjithnjë nëse fiton dyshja Thaçi-Vuçiq, shqiptarët e Maqedonisë do të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë ose edhe me Kosovën. Kjo shkatërron ekzistencën e shtetit maqedonas, sepse pjesa e mbetur do të përpihet nga Bullgaria dhe Greqia




**Uashington, 10 gusht** - Loja ballkanike akoma nuk ka filluar. Por çuditërisht janë gjetur dy arbitra të cilët si në asnjë ndeshje, do të bashkëdrejtojnë lojën për rindarjen e kufijve. Vuçiq dhe Thaçi kanë dalë në stërvitje duke pritur shtatorin për fillimin e "kampionatit të shkatërrimit ballkanik".
Karl Bild, ish-kryeministër i Suedisë, aktualisht editorialist për gazetën e rëndësishme amerikane "The Washington Post" zbulon qëndrimin e kryeministrit Rama, që siç e quan ai është pro idesë së Vuçiq."Në një takim me të, Rama, ishte i hapur për idenë e Vuçiqit, siç më tha mua", shkruan ish-kryeministri Bild për gazetën amerikane.
"Mund të ketë versione të ndryshme të skemave të ndarjes. Kosova mund të lëshojë zonën në veri të lumit Ibër, e banuar pothuajse ekskluzivisht nga serbët dhe pastaj të fitojë njohje diplomatike dhe ndoshta të fitojë edhe disa lokalitete kryesisht të banuara në Serbinë jugore. Presidenti serb Aleksander Vuçiq po mendon përgjatë disa prej këtyre linjave dhe kryeministri shqiptar Edi Rama duket të ketë qenë gjithashtu i hapur për këtë ide, siç më tha në bisedë", shkruan Bild.
"Dhe pastaj ekziston çështja edhe më e vështirë dhe e rrezikshme e Maqedonisë, ku shqiptarët janë pjesë e konsiderueshme e popullsisë. Do të ketë patjetër nga ata që pyesin pse kjo nuk duhet të zbatohet edhe në Maqedoni. Kjo do të ishte seriozisht të luaje me zjarrin. Ka nga ata në Bruksel dhe Uashington që mund të thonë se nëse liderët në rajon bien dakord për një shkëmbim territori mes Serbisë dhe Kosovës, pse duhet të kemi ndonjë kundërshtim? Sidomos nëse përfshihet krijimi i marrëdhënieve të plota diplomatike? Por një qëndrim i tillë është i rrezikshëm. Në një kohë kur e gjithë vëmendja duhet t'i kushtohet nxitjes së stabilitetit, me këto çështje thjesht nxit e krijon tronditje në dekadat e ardhshme", ka shkruar ai.
Këto shkruan ish-kryeministri i Suedisë, një nga njohësit më të mëdhenj të raporteve Serbi-Kosovë në arenën ndërkombëtare. Por siç nënvizon Bild, gjithnjë nëse zbatohet ky pazar Thaçi-Vuçiq, do të plasë lufta në Maqedoni. Shqiptarët atje janë shtetformues dhe popullsi e madhe në rritje demografike, aq sa maqedonasit i ulin me hile përqindjet e popullsisë shqiptare në 22 për qind, por e vërteta mbetet se 40 % janë shqiptarë në shtetin maqedonas. Dhe me tendencë rritje, duke kaluar maqedonasit. Shqetësimi krijohet se pas shkëmbimeve mes Kosovës dhe Serbisë, gjithnjë nëse fiton dyshja Thaçi-Vuçiq, shqiptarët e Maqedonisë do të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë ose edhe me Kosovën. Kjo shkatërron ekzistencën e shtetit maqedonas, sepse pjesa e mbetur do të përpihet nga Bullgaria dhe Greqia. Por efekti domino do të sjellë që Shqipëria të kërkojë nga Greqia tokat çame. Po kështu Serbia do të marrë Republikën Srpska në shtetin e brishtë të Bosnjës. Sherri sllovenokroat do të rindizet për kufijtë. Edhe atje do të kërkojnë një rindarje kufijsh. Shqiptarët e Mali të Zi mund të thonë se "duam edhe ne me Shqipërinë".
Dhe kazani ballkanik ndizet!
Pothuaj me një skenar djallëzor filloi Lufta e Parë Botërore, e cila nisi nga Ballkani, ndonëse kishte një vrasje. Vrasja e Franz Ferdinand dhe gruas së tij Sophie, Dukesha e Hohenberg, ndodhi më 28 qershor 1914 në Sarajevë. Më pas plasi Lufta. Lufta e Parë Botërore filloi më 28 korrik 1914 dhe zgjati deri më 11 nëntor 1918. Konflikti i parë i madh botëror i shekullit XX, "Lufta e Madhe", që mobilizoi 70 milionë ushtarë nga të gjitha kontinentet, shkaktoi vdekjen e 10 milionë personave dhe 20 milionë të plagosurve mes luftëtarëve, me miliona të vdekur civilë dhe rënien e katër perandorive (ruse, austro-hungareze, gjermane dhe otomane).
Natyrisht kushtet kanë ndryshuar. Nuk është ai Ballkan me armë pushke, si atëherë! Tani ka teknologji me të avancuar…
Ndaj marrëveshja Vuçiq-Thaçi duhet parë me kujdes, sepse nëse shkakton trauma të reja popullsisë shqiptare në rajon dhe bllokimin e Kosovës apo humbjen e trevave shqipfolëse në rajon; atëherë më mirë të mos nisë.
Veton Surroi thotë se kjo duhet ndaluar urgjent pasi do të shkatërrojë jo vetëm Kosovën, por krejt Ballkanin. Kryeministri kosovar Haradinaj shton se kufijtë ndryshojnë vetëm me luftë.
Ndërkohë shqiptarët e Maqedonisë janë me "vesh në krahë" për t'u bashkuar me Shqipërinë ose me Kosovën, nëse hapet rishikimi i kufijve nga Thaçi-Vuçiq.
Ballkani mbetet me fitil ndezur!

## Komisioni Evropian: Zgjidhja duhet të jetë realiste dhe e mundshme

**Bruksel, 10 gusht** - Një zgjidhje e përhershme nënkupton një zgjidhje realiste, e qëndrueshme dhe e mundshme, në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare, e mbi të cilën Prishtina dhe Beogradi duhet të kenë pajtueshmëri, ka deklaruar të premten në Bruksel zëdhënësi i Komisionit Evropian, Carlos Martin.
I pyetur nëse Komisioni Evropian mbështet qëndrimin e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për ndarje ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, ai ka thënë se gjatë takimit të nivelit të lartë, Vuçiqi dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kanë pasur "bisedime intensive dhe produktive mbi kornizën e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe se janë pajtuar për intensifikimin e punëve".
Martin ka shtuar gjithashtu se më 18 korrik, "Vuçiqi dhe Thaçi kanë shqyrtuar përparimin e arritur dhe janë pajtuar të takohen sërish në fillim të shtatorit".

## Avramopoulos njofton Hoxhajn se ka kërkuar nga dy institucionet e BE-së heqjen e vizave

**Prishtinë, 10 gusht** - Komisionari për Punë të Brendshme dhe Emigrim i Bashkimit Evropian (BE), Dmitris Avramopoulos, i ka shkruar letër zëvendëskryeministrit të Kosovës, Enver Hoxhaj, në të cilën ka thënë se e njeh progresin e Kosovës në rrugën drejt liberalizimit të vizave.
Ai ka bërë me dije se tashmë ka kërkuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli që ta adaptojnë propozimin e Komisionit Evropian për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës.
"Më 19 korrik Komisioni konfirmoi se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e parapara për liberalizimin e vizave. Kosova ka shënuar progres të madh në dy vjetët e fundit dhe është e rëndësishme që implementimi i reformave të vazhdojë. Tashmë kam ftuar Parlamentin Evropian dhe Këshillin që ta adaptojë propozimin e Komisionit Evropian për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës", ka shkruar Avramopoulos në letrën e tij drejtuar zëvendëskryeministrit Hoxhaj.
Ai ka siguruar Hoxhajn për mbështetjen e tij të plotë ndaj Kosovës.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Analistët politikë kanë komentuar idenë e presidentit Hashim Thaçi për mundësinë e bashkimit të Luginë së Preshevës me Kosovën

# Analistët: Bashkimi i Luginës me Kosovën, i pamundur

Analistët politikë kanë mohuar mundësinë e bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën përmes korrigjimit të kufirit me Serbinë. Teksa kanë komentuar idenë e presidenti Hashim Thaçi për këtë çështje, Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo është e pamundur, duke shtuar se presidenti qëllimisht e ka ngritur këtë çështje përpara formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 GUSHT - Njohësit e rrethanave politike në vend e shohin si të pamundur idenë e presidentit Hashim Thaçi që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës përmes korrigjimit të kufirit me Serbinë. Behxhet Shala dhe Imer Mushkolaj kanë treguar për gazetën "Epoka e re" se pse po proklamohet kjo ide tani nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ata kanë deklaruar se kjo është një lojë e kreut të shtetit për ta plasuar më lehtë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, i cili, sipas tyre, pritet të ketë kompetenca ekzekutive.

Analisti Behxhet Shala ka thënë se kjo ide mund të jetë e rrezikshme për Kosovën. "Së pari, Hashim Thaçi e di shumë mirë se kurrë nuk ka shans ta bashkojë Luginën e Preshevës, sepse Serbia nuk do të pranojë asnjëherë t'ia japë Kosovës Luginën e Preshevës. Asociacioni do të jetë çmimi që Kosova duhet ta paguajë përballë Serbisë. Nuk do të ketë as ndryshim kufijsh, as shkëmbim të territoreve, as korrigjim të kufijve. Historikisht shqiptarët asnjëherë nuk kanë shënuar fitore kur kanë filluar të bëjnë lojëra me kufij. Kështu që, as kësaj radhe nuk ka shans të fitojë diçka Kosova", ka thënë Shala.

Ai ka treguar se kjo ide është një lojë për ta bërë më lehtë të pranueshme në opinion Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Këto janë më tepër lojëra për ta fshehur qëllimin e fundit që është formimi i asociacionit. Mendoj se Thaçi dhe Vuçiqi kanë arritur një marrëveshje dhe tani vetëm po kërkojnë mënyra se si ta plasojnë në opinion atë pa shkaktuar turbulenca të mëdha. Serbia në këtë rast do të fitojë në mënyrë absolute, sepse nga asgjë po fiton diçka. Ndërkaq Kosova është humbëse, sepse nga ajo që ka po humbet diçka", është shprehur ai, duke shtuar se ky asociacion do të ketë kompetenca ekzekutive. "Asociacioni është i rrezikshëm për faktin se do të ketë kompetenca ekzekutive dhe, si i tillë, do të jetë një pushtet i tretë. Ndonëse këta po thonë se nuk do të ketë kompetenca të tilla, po e shohim se serbët dhe bashkësia ndërkombëtare as që po i marrin parasysh vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa ne për konsum të brendshëm po i tregojmë muskujt duke deklaruar se Kushtetuesja do të jetë ajo e cila do të vendosë në fund për asociacionin", është shprehur Shala.

Edhe analisti tjetër politik Imer Mushkolaj ka thënë se këto veprime të presidentit Hashim Thaçi po bëhen për shkak të asociacionit. "Presidenti Hashim Thaçi po thotë se ka për synim ta korrigjojë kufirin duke ia kthyer Kosovës Preshevën, por duke mos i dhënë asgjë Serbisë. Kjo është e pamundur të ndodhë. Ndërkaq idetë për shkëmbim territoresh e ndarje të Kosovës janë të rrezikshme dhe aventureske. Në deklaratat e tij, Thaçi është kontrovers dhe jonkonsistent", ka thënë Mushkolaj. Sipas tij, shefi i shtetit përmes kësaj ideje po përpiqet ta neutralizojë dëmin që do t'i bëhet vendit. "Thaçi ka ndërmarrë këtë ofensivë mediatike për të folur rreth korrigjimit të kufijve para vazhdimit të fazës finale të dialogut në Bruksel dhe para themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që do të jetë një trupë autonome me kompetenca ekzekutive brenda vendit. Në këtë mënyrë, Thaçi po përpiqet ta neutralizojë dëmin që do t'i bëhet vendit, duke i thënë veriut praktikisht një autonomi dhe duke rrezikuar që Kosovën ta kthejë në një shtet jofunksional", ka thënë Mushkolaj.

Në javët e fundit presidenti Hashim Thaçi disa herë përmes konferencave për medie u është adresuar qytetarëve të Kosovës për këtë çështje, duke u zotuar se këtë ide do ta prezantojë edhe në Bruksel në fazën e fundit të dialogut me Serbinë. "Jo ndarje të Kosovës, jo shkëmbim të territoreve, po bashkim të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit me Kosovën në kuadër të korrigjimit të kufirit midis Kosovës dhe Serbisë, në procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore në mënyrë paqësore. Ky proces, nëse tregohemi të mençur dhe të bashkuar, do të përmbyllet me njohje reciproke Kosovë - Serbi, dhe Kosova do të anëtarësohet në të gjitha organizatat ndërkombëtare: në BE, NATO dhe OKB", është shprehur Thaçi.

Kjo ide është kundërshtuar nga partitë e koalicionit qeverisës dhe opozita, me pretendimin se lëvizja e kufijve për Kosovën mund të jetë e rrezikshme. Duke e parë kundërshtimin e kësaj ide, i pari i vendit ka deklaruar se nuk mbetet rrugë tjetër përveç fuqizimit të vendimmarrjes së qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke u mundësuar atyre për të vendosur vetë me anë të referendumit se kush ka të drejtë dhe se cili opsion është në interes të Kosovës. "Është e domosdoshme t'u mundësojmë qytetarëve tanë të drejtën e referendumit, për të cilën jam duke punuar që të bëhet realitet", ka deklaruar Thaçi.

# Delawie: Miqësia ShBA - Kosovë nuk do të ndryshojë



PRISHTINË, 10 GUSHT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Greg Delawie, ka thënë se shteti i tij nuk ka ndryshuar dhe se ende vazhdon të jetë një nga mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës dhe pavarësisë së saj. Deklaratat e Delawies vijnë pas komenteve, kryesisht të politikanëve në Beograd, se administrata e presidentit Donald Trump "nuk e mbështet pavarësinë e Kosovës", ashtu siç e kanë mbështetur administratat e mëhershme. "Shtetet e Bashkuara janë një nga miqtë dhe mbështetësit më të afërt të Kosovës, edhe pse ju mund te lexoni diçka tjetër në media, kjo nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë", ka thënë të premten Delawie, duke shtuar se miqësia mes dy vendeve tona është e thellë dhe është shumëdimensionale. "Ne punojmë shumë çdo ditë për t'i avancuar qëllimet tona, siç janë demokracia, siguria dhe prosperiteti", ka deklaruar ambasadori amerikan Greg Delawie.

Flet për "Epokën e re", Besnik Osmani

# Rekomandimet e Zyrës së Aud



Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka thënë se institucionet e vendit duhet të jenë më fleksibile sa i përket marrjes parasysh të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është e kënaqshme. Osmani ka theksuar se është e nevojshme të rritet fokusi në zbatimin e rekomandimeve, pasi kjo do të rezultonte me qeverisje të mirë dhe shërbime kualitative për qytetarët. Ai ka bërë me dije se arsyet për zbatim të ulët të rekomandimeve janë mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre. Osmani ka thënë se Kuvendi dhe Qeveria kanë dështuar të sigurojnë kushte për punë sa i përket akomodimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 GUSHT-

**"Epoka e re":** *Z. Osmani, çfarë përmban plani strategjik i Zyrës Kombëtare të Auditimit 2018 - 2021?*

**Osmani:** Për herën e parë, para pak ditësh, pas një procesi gjithëpërfshirës dhe intensiv, kemi miratuar planin e ri strategjik 2018-2021, ku kemi përcaktuar tri qëllime kryesore që kanë të bëjnë me përmbushjen e misionit për të kryer auditime relevante, në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit, të zhvillojmë dhe forcojmë kapacitetin institucional për ta mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative dhe të zhvillojmë e mirëmbajmë marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të institucioneve supreme të auditimit.

Gjatë tre vjetëve të ardhshëm synojmë që, krahas përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së produkteve të auditimit, ta zgjerojmë portofolin e auditimeve të performancës dhe të ndërmarrjeve publike, ta azhurnojnë metodologjinë e punës për të filluar me dhënien e opinionit edhe për auditime të pajtueshmërisë, si dhe ta zhvillojnë qasjen për përzgjedhjen e institucioneve dhe temave audituese bazuar në vlerësimin e rrezikut. Synim tjetër është edhe

# itorit të merren më seriozisht



integrimi i Institucionit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në organizatat globale dhe rajonale të institucioneve supreme të auditimit. Për realizimin e këtyre synimeve Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me mandatin e saj, do të bashkëpunojë ngushtë, përveç me Kuvendin e Kosovës dhe me organizatat e shoqërisë civile dhe mediet, Qeverinë dhe subjektet e audituara, institucionet e zbatimit të ligjit, partnerët profesionalë që janë institucionet homologe të auditimit dhe organizatat profesionale rajonale dhe ndërkombëtare të auditimit, institucionet akademike, shoqatat profesionale, donatorët etj.

**"Epoka e re":** *Në disa raste nuk janë zbatuar rekomandimet e dhëna nga raporti i auditorit sa i përket auditimti të ndërmarrjeve publike, po ashtu edhe të nivelit lokal. Si duhet të ndryshohet kjo çështje?*

**Osmani:** Niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga ana e organizatave buxhetore është një tregues i rëndësishëm nëse ato kanë të zhvilluara sisteme efikase dhe efektive në arritjen e objektivave të veta. Nga analizat tona që burojnë nga veprimtaria audituese del se shkalla e zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është e kënaqshme. Arsyet për zbatim të ulët të rekomandimeve janë mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse ka ndikuar që organizatat buxhetore ta shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten. Përfundimisht, ne kemi nevojë ta rrisim fokusin në zbatimin e rekomandimeve, pasi kjo do të rezultonte me qeverisje të mirë dhe shërbime kualitative për qytetarët. Mesatarja e përgjithshme e zbatimit të rekomandimeve është 25.38 për qind për nivelin lokal të qeverisjes. Një qasje serioze nga menaxhmenti i çdo komune për zbatim të rekomandimeve është thelbësore që të arrihen përfitimet maksimale nga raporti i auditimit.

Sa i përket Ndërmarrjeve Publike (NP), auditimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2017 ka nxjerrë në pah se sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në NP ka nevojë për përmirësime thelbësore. Fakti që për nëntë ndërmarrje janë dhënë opinione të modifikuara, tregon për cilësi jo të mirë të raportimit dhe operimit të sistemeve financiare. Të gjitha pasqyrat financiare të audituara kanë rezultuar me pasaktësi të të dhënave financiare dhe, rrjedhimisht, me gabime materiale. Ndërmarrjet publike janë audituar nga kompani audituese private. Në vitin paraprak kanë rezultuar me numër më të ulët të rekomandimeve për shkak se fokusi dhe metodologjia e punës së tyre ishte e përqendruar kryesisht tek pjesa e raportimeve financiare, më pak te pajtueshmëria me rregulloret. Nga rekomandimet e dhëna në vitin paraprak, rreth 30 për qind prej tyre janë zbatuar, 30 për qind janë në proces të zbatimit dhe 40 për qind ende nuk janë adresuar. Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak vërehet sidomos te ndërmarrjet që ishin audituar për herë të parë nga ZKA.

**"Epoka e re":** *Sa është numri i auditorëve në Kosovë dhe a është i mjaftueshëm për tregun e Kosovës?*

**Osmani:** Kapacitetet tona janë në zhvillim të vazhdueshëm. Ne i kushtojmë kujdes të veçantë kompetencës profesionale të resurseve humane. Aktualisht kemi 135 auditorë të angazhuar për zbatimin e përgjegjësive që burojnë nga kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm nga të cilët 39 auditorë të certifikuar për sistemin akrual të kontabilitetit dhe 53 auditorë të certifikuar për sistemin e kontabilitetit në të gatshme (cash). Kujdes të veçantë po u kushtojmë përvojave ndërkombëtare dhe përmes marrëveshjeve për bashkëpunim specifik me organizata prestigjioze, disa auditorë kanë qëndruar për disa muaj në Gjykatën Evropiane të Llogarive në Luksemburg, Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në SHBA, në Institucionet Supreme të Auditimit të Suedisë, Anglisë, Polonisë etj. Këto angazhime po japin rezultate konkrete. Andaj, ne kemi kapacitete shumë të mira sa iu përket auditimeve financiare. Gjendja nuk është e kënaqshme, me kapacitetet e auditimit të sektorëve specifikë që kanë të bëjnë me sistemet e teknologjisë informative dhe telekomunikimeve, fushën e mjedisit e ambientit e të ngjashme ku kemi mungesë të auditorëve të certifikuar. Në aspektin softuerik, ne përdorim një program "Idea", që është efikas për një pjesë të procesit auditues që ka të bëjë me mostrimin. Është program që përdoret edhe nga vende të tjera të përparuara, por ne kemi nevojë urgjente dhe është në planin tonë të punës të përvetësojmë një program elektronik auditivi për fazat e tjera të proceseve audituese, pasi kjo do ta shkurtonte shumë kohën e auditorëve tanë të angazhuar, rris sigurinë dhe cilësinë e produkteve tona dhe e bën shumë pak të nevojshme përdorimin e letrës. Në komunikim me publikun, përveç përdorimit të mediave sociale, uebfaqja jonë është e pasur me informata dhe raporte dhe e lehtë për përdorim nga ana e përdoruesve të gjerë. Në disa konferenca ndërkombëtare që kanë trajtuar transparencën dhe komunikimin është dhënë si model edhe për institucionet e tjera të auditimit.

**"Epoka e re":** *Është kritikuar shuma e lartë e pagesës së qerasë. Tani që jeni në lokacion të ri, sa paguhet qiraja?*

**Osmani:** Fatkeqësisht, Kuvendi dhe Qeveria kanë dështuar t'i sigurojnë kushtet për punë sa i përket akomodimit. Mjafton një vizitë në ndërtesat që kishim në shfrytëzim deri më tani, që ta shihni krahasimin me fqinjët në Tiranë, Shkup, Podgoricë apo Beograd. Kjo çështje nuk është zgjidhur deri më sot. Po flasim për një institucion që, përkundër kësaj, ka arritur të bëhet lider jo vetëm në nivel kombëtar, por në gjithë Ballkanin Perëndimor, duke punuar edhe me këto kushte të rënda të akomodimit dhe i cili ka kompetenca shumë specifike për kontrollin e gjithëmbarshëm ekonomik dhe financiar. ZKA-ja që nga themelimi në vitin 2003 ishte akomoduar në objekte private dhe varësisht nga rritja e kapaciteteve të saj apo kushteve të kontratës është detyruar që disa herë të zhvendoset nga një lagje në tjetrën. Për dy objektet në shfrytëzim kemi paguar pas vitit 2015 rreth 12 300.00 euro në muaj, pa llogaritur kostot e parkingut për nevojat zyrtare. Objektet kanë qenë të destinuara për banim e jo për veprimtari administrative, me rreth 1 400m2 hapësirë pune nga 2 200 m2 bruto sa kanë pasur në total. Në këtë kohë, ZKA-ja kishte rreth 114 punonjës dhe në një mënyrë ky numër mund të sistemohej brenda kësaj hapësire.

Për ta përmbushur mandatin, numri i punonjësve vazhdimisht është rritur. Çdo akomodim shtesë në këtë objekt i vështirësonte kushtet e punës. Gjatë vitit 2016 dhe 2017 kemi vazhduar përpjekjet që përmes organeve kompetente të sigurojmë një objekt zyrtar apo së paku një lokacion për ndërtimin e objektit. Meqenëse kërkesat tona s'u realizuan kurrë dhe përballë kishim nevojën e akomodimit të rreth 190 punonjësve, nga të cilët 167 punonjës kosovarë dhe të tjerët nga projektet partnere ndërkombëtare, përmes një procesi të përsëritur publik, tani më 1 gusht jemi akomoduar në një objekt në lagjen Arbëria. Për këtë objekt me 3 200m2, i vendosur në një sipërfaqe prej 32.3 ari (e cila hapësirë shfrytëzohet nga ZKA, për nevojat e parkingut dhe qëllimeve të tjera logjistike), do të paguajmë 13 500.00 euro në muaj. Objekti është i ndërtuar për qëllime të punës administrative, ka hapësirë të mjaftueshme për akomodimin e kapaciteteve ekzistuese dhe ofron kushte më solide të punës. Po ashtu, e rëndësishme është që ky objekt plotëson kushtet ligjore që lidhen me sigurinë në punë, pasi është i pajisur me sistemet e alarmit dhe shkallëve emergjente dhe është objekt i ndërtuar me leje.

Edhe ky akomodim do të jetë i përkohshëm dhe shpresoj shumë i shkurtër, në momentin që Qeveria do të këtë siguruar ndërtesën e përhershme dhe në pronësi publike, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm përfundimisht do të mund të vazhdojë punën në kushte normale, por edhe duke kursyer disa dhjetëra mijëra euro që sot përdoren për qiratë. Paramendojeni sa larg do të kishim shkuar, me kapacitetet profesionale, po sikur në vend të qirasë të paguajmë këtë buxhet për nevojat e edukimit profesional të auditorëve, që është një zanat që kërkon shkollim të vazhdueshëm dhe përditësim të njohurive.

**"Epoka e re":** *Është kërkuar që për disa ndërmarrje publike të ketë auditim nga kompani të huaja. Është i nevojshme një angazhim i tillë?*

**Osmani:** Deri më tani ndërmarrjet publike janë audituar nga kompani auditimi të certifikuara dhe këto kompani janë angazhuar nga vetë ndërmarrjet publike për qëllime të auditimit të pasqyrave financiare. Sa herë që mund të konsiderohet e nevojshme nga ana e menaxhmentit apo aksionarëve të këtyre ndërmarrjeve publike mund të bëhen auditime që kanë në fokus çështje të caktuara dhe që janë në interes për palët e interesuara. Përfshirë këtu edhe kompani private prestigjioze ndërkombëtare të auditimit. Natyrisht që këto shërbime duhet të paguhen. Është e rëndësishme që auditimi të kryhet nga organizata të auditimit që kanë dëshmuar pavarësinë e punës dhe kompetencën profesionale. Po punojmë që paralelisht, me ngritjen e kapaciteteve tona, ta rrisim numrin e ndërmarrjeve publike që do të auditohen nga ana jonë. Vitin e parë kemi audituar gjashtë ndërmarrje, vitin e dytë nëntë dhe në planin e punës për auditimin e pasqyrave financiare 2018 do të jenë 12 ndërmarrje publike, përfshirë sektorin e hekurudhave dhe sektorin e telekomunikacionit.

## Sulmohet Ambasada e Kosovës në Stokholm

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka njoftuar se Ambasada e Kosovës në Stokholm është sulmuar me mjete të forta. Përmes një komunikate për medie MPJ-ja ka dënuar sulmin duke kërkuar prej autoriteteve suedeze sa më shpejt ta zbardhin rastin dhe kryerësit e kësaj vepre të sillen para drejtësisë. "Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson se sulmet e tilla me mjete të forta kanë mundur të shkaktojnë lëndime të rënda ndaj personelit diplomatik. Përderisa ata kanë qenë në kryerje të detyrës zyrtare këto sulme janë të papranueshme dhe kërkojmë nga autoritetet e shtetit pritës të zbardhen sa më shpejt kryerësit e kësaj vepre në mënyrë që ata të sillen para drejtësisë", është thënë në komunikatën e MPJ-së. Ministria e Punëve të Jashtme ka falënderuar autoritetet suedeze për reagimin e shpejtë dhe bashkëpunimin e ngushtë në lidhje me këtë rast. Ky është sulmi i dytë ndaj Ambasadës së Republikës së Kosovës në Stokholm që nga hapja e saj në vitin 2009.




# Liderët shtetërorë kujtojnë 'Abejën' dhe dëshmorët e tjerë





Prishtinë, 10 gusht (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar dëshmorët Bekim Berisha, Bedri Shala, Elton Zherka dhe Permet Vula, të cilët kanë rënë heroikisht në betejën e Junikut. Ai ka thënë se këta dëshmorë me atdhedashurinë dhe guximin e tyre motivuan shumë të rinj dhe të reja t'u bashkohen radhëve të UÇK-së. "Me atdhedashurinë dhe guximin e tyre, si eprorë dhe luftëtarë të shquar, ata motivuan shumë të rinj dhe të reja që t'u bashkohen radhëve të UÇK-së. Kontributi, sakrifica dhe veprat e tyre do të jetojnë përgjithmonë si pjesë e lavdishme e historisë sonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se Bekim Berisha-"Abeja", Bedri Shala, Elton Zherka dhe Përmet Vula do të jetojnë përherë ashtu siç do të jetojë liria dhe shteti i Kosovës. "Me shembullin e tyre të trimërisë dhe sakrificës më të lartë për atdheun ata e bënë edhe më të fortë dhe më të vendosur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në misionin e saj të lirisë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar dëshmorët e kombit Bekim Berisha, Bedri Shala, Elton Zherka dhe Përmet Vula në 20-vjetorin e rënies.

Haradinaj i ka quajtur ata shqiptarë të mëdhenj që i dhanë drejtim historisë së Kosovës. "Idetë e mëdha të atdheut dhe lirisë nuk vdesin kurrë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka kujtuar këta dëshmorë. "Kosova sot nderon dhe përkujton me pietet të lartë heronjtë e kombit Bekim Berisha-'Abeja', Bedri Shala, Elton Zherka dhe Permet Vula", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se Bekim Berisha-"Abeja" bashkë me bashkëluftëtarët ranë në altarin e lirisë 20 vjet më parë duke i dalë zot vendit. "Kontributi i jashtëzakonshëm i Bekim Berishës-'Abesë' për lirinë e Kosovës ishte dhe do të mbetet frymëzim edhe për brezat e ardhshëm. Liria e Kosovës është arritur me mundin, sakrificën dhe gjakun e shumë brezave. Kosova do t'i nderojë dhe do t'u jetë përjetë mirënjohëse të gjithë atyre që e bënë të mundur lirinë e Kosovës", ka shkruar Limaj.

# Ministrja Hoxha: Zbatimi i MSA-së, prioritet i Qeverisë

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Kanadasë në Kroaci, jorezident për Republikën e Kosovës, Daniel Maksymiuk, me të cilin ka diskutuar për procesin integrues dhe angazhimin institucional në këtë drejtim. "Zbatimi i MSA-së është detyrë me prioritet e Qeverisë", ka thënë ministrja Hoxha në këtë takim, duke theksuar se kjo marrëveshje është kontrata e parë në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Ministrja ka çmuar lart përkrahjen e Kanadasë dhe miqësinë e saj për qytetarët dhe shtetin e Kosovës, duke e quajtur miqësi shembullore. "Procesi integrues është prioritet konsensual i vendit tonë, i partive politike dhe institucioneve qendrore e lokale, pa dallim. Ne kemi dëshmuar se jemi gati për procesin e liberalizimit të vizave, kemi plotësuar të gjitha kriteret si dhe jemi gati t'i zbatojmë obligimet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se reformat e ndërmarra dhe shtimi i angazhimit institucional për procesin integrues janë gjithëpërfshirëse.

Ambasadori jorezident për Republikën e Kosovës, Daniel Maksymiuk, ka theksuar se përkrah përkushtimin e Kosovës për rrugën integruese, duke ofruar përkrahjen e vendit të tij në këtë proces. "Kanadaja ka qëndruar dhe qëndron krah Kosovës", ka theksuar Maksymiuk.



## Ndahet mirënjohja "Ora e presidentit 2018" për veprimtarin Hebib Shehu

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Nën organizimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është ndarë mirënjohja "Ora e presidentit 2018" për veprimtarin e kamotshëm të LDK-së, Hebib Shehu.

Nënkryetari i LDK-së, kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, u uroi mirëseardhje të gjithëve të pranishmëve, duke theksuar rëndësinë e këtij çmimi shumë domethënës dhe tradicional që për çdo vit u jepet personaliteteve të ndryshme të cilët kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm për LDK-në dhe vendin tonë. "Z. Hebibit i dëshiroj shëndet, jetë sa më shumë dhe të vazhdojë në mesin tonë, sepse kemi nevojë ende për këtë gjeneratë, për këshillat dhe punën e tyre", ka deklaruar Veliu.



# Protestohet në Gjakovë për vrasjen e dyfishtë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

GJAKOVË, 10 GUSHT - Me pankartat "Mos shfajësoni fajtorët" dhe "Reagoni me kohë", shoqëria civile e Gjakovë, e përkrahur nga Rrjeti i Grave të Kosovës, të premten kanë marshuar prej Parkut të Qytetit deri tek Çarshia e Vogël për ta kundërshtuar vrasjen e gruas 40-vjeçare dhe vajzës së saj, në Brekoc të Gjakovës.
Kjo protestë është organizuar edhe për të kërkuar përgjegjësi nga institucionet e Kosovës për këtë dhe shumë raste të tjera të dhunës në Kosovë.
Marshit protestues të organizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës i është bashkuar edhe ish-presidentja e vendit, Atifete Jahjaga dhe deputetja Mimoza Kusari-Lila. Edhe ato së bashku me shuma gra të tjera kanë mbajtur pankarta në duar me mbishkrimin "Reagoni me kohë", duke kërkuar drejtësi pas vrasjes së Valbona Marku Nrecajt dhe vajzës së saj.
Ish-presidentja Atifete Jahjaga iu drejtua të pranishmëve në protestë duke u thënë se heshtja e organeve të drejtësisë është e papranueshme. "Edhe sa thirrje të humbura duhet t'i keni?! Edhe sa jetë duhet të shuhen që institucionet të reagojnë?! Kush do të japë përgjegjësi për këto krime që nuk kanë të ndalur?", ka thënë Jahjaga. Ajo ka shtuar se dhuna ndaj gruas nuk duhet të ketë arsyetim dhe se ata po marshojnë për të thënë mjaft më me vrasjen e grave dhe vajzave.
Në mesin e protestuesve janë edhe fëmijët e së ndjerës, të cilët mbajnë bluza me fotografinë e motrës dhe mbishkrimin "Drejtësi për Klarën".
Në mesin e pankartave ishte edhe ajo që e mbante i biri i viktimës në dorë me mbishkrimin "Të dua nënë". Shkëlzen Marku, vëllai i gruas së vrarë Valbona Marku, ka bërë me dije se shteti i ka neglizhuar dhe nuk është marrë me ta. Sipas tij, pas të pamës do të vazhdojnë të kërkojnë drejtësi për motrën dhe mbesën e tyre. 40-vjeçarja Valbona Nrecaj dhe vajza e saj nëntëvjeçare u qëlluan për vdekje mbrëmjen e 7 gushtit nga bashkëshorti i viktimës.






Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë kanë mbajtur të premten një konferencë për media në lidhje me vrasjen e dyfishtë në Gjakovë, ku është privuar nga jeta Valbona Marku-Nrecaj dhe e bija e saj nëntëvjeçare. Nënkoloneli Ahmet Hasi ka bërë me dije se ditën e vrasjes, më 7 gusht, viktima ishte paraqitur në polici rreth orës 15:30, me ç'rast ka njoftuar se kishte pranuar mesazhe kërcënuese nga i dyshuari, Pjetër Nrecaj. Sipas Hasit, policia ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe ka hapur rastin si kanosje. "Policia menjëherë ka ndërmarrë masat për kërkimin dhe arrestimin e të dyshuarit. Fillimisht është kërkuar në shtëpinë e tij, më pas edhe në disa lokacione ku ka pasur informacione që mund të gjendet. Në pamundësi të gjetjes është provuar të kontaktohet edhe përmes telefonit", ka thënë Hasi. Nënkoloneli ka bërë me dije se viktima nuk ka kërkuar mbrojtje apo strehim. Ndërkohë Inspektorati Policor i Kosovës ka nisur hetimet ndaj zyrtarëve policorë që ishin të përfshirë në këtë rast.

## 30 ditë paraburgim për Pjetër Nrecajn

Gjykata Themelore në Gjakovë ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji të pandehurit Pjetër Nrecaj, pasi dyshohet për vrasjen e dyfishtë, e cila kishte ndodhur të martën mbrëma në fshatin Brekoc të Gjakovës. Gjykatësi i rastit, Shaqir Zika, seancën dëgjimore e ka mbajtur në Spitalin Rajonal të Gjakovës "Isa Grezda", në repartin e Psikiatrisë, ku i pranishëm ka qenë edhe prokurori i Shtetit, Agron Matjani, avokatja e të pandehurit, Fehmije Zhubi, si dhe psikiatri Zef Komani.

# 36 amerikanë betohen për punë vullnetare në Kosovë

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 10 GUSHT - Grupi i pestë i vullnetarëve amerikanë të Korpusit të Paqes në Kosovë është betuar për punë vullnetare në Kosovë. Drejtoresha për Program dhe Trajnime në këtë korpus, Karen Scheuerer, është shprehur falënderuese ndaj të gjithë pjesëmarrësve në trajnime që u kanë mundësuar vullnetarëve njohuri se si të veprojnë gjatë qëndrimit në Kosovë.
Scheuerer ka pohuar se 36 vullnetarët amerikanë do të shërbejnë në qytete dhe fshatra të ndryshme të Kosovës, si: Drenas, Prishtinë, Kaçanik, Gjakovë, Gjilan, Llapnasellë e të tjera. Ndërsa drejtoresha e Korpusit të Paqes në Kosovë, Darlene Grant, ka thënë se një prej pozitave më të çmuara që një amerikan mban është duke punuar në mënyrë vullnetare. "Korpusi i Paqes është shpresë në veprim, është shpresë për një botë më të mirë, për të ndihmuar të tjerët të ngrehën. Do t'i ndihmojmë Kosovës që të ngrehet", ka thënë ajo.
Ambasadori amerikan në Kosovë,



Greg Delawie, ka theksuar se këta vullnetarë përfaqësojnë partneritetin mes ShBA-së dhe Kosovës. "Do të ndërtoni miqësi me kosovarët nga të gjitha komunitetet. Nuk ka manifestim më të prekshëm sesa shtrirja e dorës përmes Korpusit të Paqes. Jam i bindur se ju do t'i përmbushni qëllimet tuaja. Gjatë dy vjetëve e keni mundësinë t'ia ndryshoni jetën dikujt për të mirë", është shprehur Delawie.
Falënderues për punën e vullnetarëve të amerikanëve u shpreh edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi. "Sot nxënësit tanë mësojnë anglisht dhe veti të tjera falë jush, për një botë më të mirë. Kjo është sfidë për një arsim më të mirë, pa të cilin nuk ka cilësi jeta e as ekonomia", ka deklaruar ministri Bytyqi.
Vullnetarët e rinj amerikanë do të qëndrojnë në Kosovë dy vjet dhe do të sistemohen në familjet e Kosovës, duke shërbyer vullnetarisht për t'u ndihmuar në përmirësimin e jetës së tyre.

# Çmimet e konsumit ditor, 1.2 për qind më të larta se vjet




EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin korrik të vitit 2018. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit prej muajit janar 2016 publikohet me vitin bazë 2015=100. Inflacioni mujor i matur në korrik 2018 nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.2 %, ndërsa inflacioni vjetor ishte 1.2 %.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.2 % në muajin korrik 2018, krahasuar me muajin qershor 2018. Kjo është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: mish (1.1 %); qumësht, djathë dhe vezë (1.4 %); përdorim i pajisjeve për transportin personal (0.8 %)-(ngritje e çmimit të naftës dhe benzinës); shërbime për transport (7.2 %)-(ngritje e çmimeve të biletave të udhëtarëve me aeroplan) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.5 përqindësh në IHÇK.

Ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: pemë (-2.5 %); perime (-5.1 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 %) në IHÇK.

Ndërkaq, Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 1.2 % në muajin korrik 2018, krahasuar me muajin korrik 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (1.4 %); mish (2.3 %); qumësht, djathë dhe vezë (4.7 %); perime (12.2 %); duhan (3.9 %); përdorim i pajisjeve për transportin personal (9.8 %) - (ngritje e çmimit të naftës dhe benzinës); shërbimet hoteliere (2.3 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1.9 përqindësh në IHÇK.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: sheqer dhe ëmbëlsira (-8.1 %); veshje (-1.4 %); energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (-7 %); pajisje shtëpiake (-2.5 %); pajisje të telefonisë mobile (-8.4 %); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-4.6 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7) përlindësh në IHÇK.

# Ndahen 50 mijë euro për pastrimin e Lepencit nga azbesti

EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 GUSHT - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me kryetarin e Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, të premten kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për projektin "Pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit" i cili ka vlerë prej 50 mijë eurosh dhe financohet nga MMPH-ja.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, ministri Matoshi ka thënë se MMPH-ja do të vazhdojë ta përkrahë Komunën e Hanit të Elezit në fushat që lidhen me mjedisin dhe planifikimin hapësinor. "Sapo nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi për financimin e projektit që ka të bëjë me largimin e azbestit në lumin Lepenc dhe rreth tij. Hani i Elezit është ndër komunat më të varfra në Kosovë për të cilën ne si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk do të kursehemi ta mbështesim zhvillimin e saj jo vetëm në këtë projekt, por në të gjitha fushat që lidhen me mjedisin dhe planifikimin hapësinor", ka deklaruar Matoshi.

Ministri Matoshi dhe kryetari Suma gjatë takimit kanë diskutuar edhe për aksionin e pastrimit në nivel të vendit që do të fillojë më 15 shator në Republikën e Kosovës dhe do ta përfshijë edhe Komunën e Hanit të Elezit. "Hani i Elezit është komunë kufitare, është një nga pikat kufitare më të frekuentuara të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë dhe një vëmendje të veçantë do ta kemi gjatë aksionit për pastrim edhe në këtë komunë andaj presim bashkëpunim me ta", ka deklaruar Matoshi.




Ndërsa kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka falënderuar ministrin Matoshi për mbështetje në financim të projektit për largimin e azbestit nga lumi Lepenc, duke e vlerësuar si një projekt të rëndësishëm për komunën. "Falënderoj u. d. e ministrit për nënshkrimin e kësaj marrëveshje. Me këtë projekt kemi të bëjmë me pastrimin e mbetjeve të azbestit në brigjet e lumit Lepenc. Në komunën tonë kemi azbest përgjatë brigjeve të lumit Lepenc dhe te fusha e futbollit. Tani përmes këtij nënshkrimi ne do të shpallim tenderin për ta larguar azbestin në këto pika", ka thënë Suma.

Projekti "Pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit" do të rregullojë një nga problemet më të mëdha dhe më të rrezikshme që ka Komuna e Hanit të Elezit, atë të largimit të azbestit.

# USAID-i vazhdon ta përkrahë zhvillimin e ATK-së

**Prishtinë, 10 gusht (ER)** - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), së bashku me menaxhmentin e lartë, të premten ka pritur në takim përfaqësues nga USAID-i në Kosovë, Markham Isom dhe Blerim Bilibani.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi për vizionin e Administratës Tatimore të Kosovës për të ardhmen, sukseset, sfidat dhe kapacitetet për zhvillim.

Drejtori Imeri përfaqësuesit nga USAID i ka njoftuar me planin e veprimit për reformë për periudhën 2019-2021, i cili në muajin gusht të këtij viti është hartuar në bashkëpunim me misionin këshillues të FMN-së. Gjatë takimit u diskutuan edhe fushat në të cilat ATK-ja dëshiron të ketë përkrahje nga donatorët dhe fushat ku USAID-i mund ta mbështesë.

USAID-i ka shprehur gatishmërinë për përkrahjen e ATK-së në realizimin e disa veprimeve nga reforma në të cilën ky institucion konsideron se do të jetë një sfidë, posaçërisht veprimet të cilat janë të nevojshme të realizohen në bashkëpunim edhe me palë të interesit. USAID-i ka qenë përkrahës i shumë proceseve në Qeverinë e Kosovës në përgjithësi, në veçanti i proceseve në ATK.



# Hasani: Kosova është e përkushtuar për reforma ekonomike



**Prishtinë, 10 gusht (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka pritur të premten në takim ambasadoren e Finlandës në Prishtinë, Pia Stjernvall.

Ministri Hasani e ka informuar ambasadoren Stjernvall për punët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për projektet që janë duke u realizuar dhe klimën e biznesit në Kosovë. "Ne ju falënderojmë për bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe Finlandës. Jam shumë mirënjohës për projektin për konkurrueshmërinë në sektorin privat. Ne si MTI përfshijmë shumë fusha të sektorit privat dhe jemi shumë të përkushtuar për reforma ekonomike, që të jemi në hap me marrëveshjet që dalin nga MSA-ja", ka thënë ministri Hasani. Po ashtu, ministri e ka njoftuar ambasadoren për mbështetjen e ndërmarrjeve që është duke iu bërë për ta ndryshuar bilancin tregtar.

Hasani ka thënë se janë duke u punuar shumë edhe në fushatë e metrologjisë, akreditimit dhe standardizimit, që janë parakushte për të eksportuar në tregun evropian. Ambasadorja Stjernvall ka shprehur gatishmërinë për ta vazhduar kooperimin dhe bashkëpunimin me ministrin Hasani në fushatë ku vlerësohet si më e nevojshme. Ambasadorja Stjernvall ka thënë se në Kosovë i ka bërë përshtypje rinia e që, sipas saj, shumë vende të tjera nuk e kanë.

## Guvernatori i BQK-së: Sektori bankar vazhdon të ketë performancë të mirë

Prishtinë, 10 gusht (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovë (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të premten në takim ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall. Mehmeti e ka njoftuar ambasadoren me zhvillimet e fundit në sektorin financiar, me theks të veçantë në sektorin bankar. "Sektori bankar vazhdon të ketë performancë të mirë dhe shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Këto zhvillime pozitive po ndikojnë edhe në rritjen e aktivitetit të tyre në mbështetje të zhvillimit ekonomik", ka deklaruar guvernatori Mehmeti.

Ai ka falënderuar ambasadoren dhe shtetin e Finlandës për mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritashëm me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit. Ndërsa ambasadorja e Finlandës, Anne Huhtamaki, ka shprehur kënaqësinë me zhvillimet në sektorin financiar,



duke shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi me BQK-në të vazhdojë edhe më tutje.

## Gjilani përfiton nga KE një projekt në vlerë prej 400 mijë eurosh



Gjilan, 10 gusht (ER) - Komuna e Gjilanit ka përfituar të premten edhe një projekt nga Komisioni Evropian, që është i katërti partneritet me këtë institucion të rëndësishëm. Marrëveshjen me Komisionin Evropian e ka nënshkruar kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ka bërë me dije se projekti kap koston e mbi 400 mijë eurove. "Këtë radhe projekti ka të bëjë me përfshirjen e të rinjve dhe vajzave në bujqësi në kuadër të promovimit për ekonomi sociale dhe qëndrueshmërisë së zhvillimit lokal ekonomik", është bërë me dije në komunikatën e Komunës së Gjilanit.

# Dua Lipës i dhurohet 'Çelësi i Prishtinës'



Prishtinë, 10 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka pritur në takim këngëtaren me famë botërore, Dua Lipa, me ç'rast i ka dhuruar "Çelësin e Prishtinës" për promovimin që i ka bërë kryeqytetit me Festivalin "Sunny Hill".

Kryetari Shpend Ahmeti ka falënderuar Duan që po e vendos Prishtinën në hartën botërore me koncertet dhe me sukseset e saj. Ndërsa Dua u shpreh të jetë e lumtur që do të performojë për të dytën herë para adhuruesve të saj në Kosovë për të cilët ndihet mirënjohëse. "Ky është vetëm fillimi për ecjen dhe përparimin e artit dhe kulturës së Kosovës që do ta bëjmë së bashku. Faleminderit për përkrahjen e vazhdueshme që më jepni! Pa juve s'do të isha këtu, sepse e di që më keni mbështetur duke dëgjuar këngët e mia". Përndryshe, kjo është hera e parë që kryetari Ahmeti ka dhuruar "Çelësin e Prishtinës".

## Haradinaj kujton dëshmorët e Brigadës 162 të Kaçanikut

Prishtinë, 10 gusht (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka kujtuar të premten dëshmorët e Brigadës 162 të Kaçanikut të rënë 20 vjet më parë. "Kaçaniku i Idriz Seferit ruajti traditën liridashëse edhe në luftën çlirimtare. Brigada 162 me krenari mbajti emrin e Agim Bajramit. Sot në përvjetorin e rënies së tij dhe bashkëluftëtarëve Besnik Begunca dhe Xheladin Kurtaj kujtojmë me pietet luftën dhe flijimin e tyre për lirinë e Kosovës. Kaçaniku me kaq shumë ngjarje dhe vendimmarrje historike është vendi që inspiron brezat për t'iu bërë mburojë atdheut dhe lirisë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit!", ka shkruar kryeministri Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Prishtinës nga shtatori i këtij viti i shtohet edhe një shkollë moderne

Prishtinë, 10 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, së bashkë me nënkryetarin Selim Pacolli, drejtorin e Arsimit, Jonuz Salihaj, kanë vizituar të premten përfundimin e punimeve në objektin e shkollës fillore dhe të mesme të ulët në lagjen "Arbëria".



Shkolla që do të mbajë emrin "Mehmet Gjevori" në përbërje ka gjithsejtë 12 dhoma mësimi, prej të cilave dy dhoma mësimi për nivelin e arsimit parafillor, 10 dhoma mësimi për nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe katër dhoma për kabinete, kuzhinën dhe hapësirat e tjera përcjellëse sipas kërkesave dhe standardeve bashkëkohore.

Drejtoria e Arsimit, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi demografinë e popullsisë në lagjet apo zonimin ku shtrihen shkollat fillore, si: ShFMU "Meto Bajraktari", "Qamil Batalli" dhe "Faik Konica" ka konstatuar se numri i nxënësve në këto shkolla është i madh nëpër paralele, prandaj rreth 17 paralele nga viti i ri shkollor 2018/19 do të transferohen në shkollën e re në lagjen "Arbëria".

Për të siguruar një transferim të lehtë i gjithë ky proces do të realizohet në koordinim të plotë me drejtuesit e shkollave dhe organet e brendshme të shkollës. Po ashtu, javën e ardhshme do të bëhet edhe prezantimi i draftprojekteve konceptuale i pesë objekteve shkollore që do të ndërtohen me programin PFI në bashkëpunim me Bankën Botërore.

## Të hënën në Obiliq do të bëhet përurimi i qendrës për pajisje me dokumente



Prishtinë, 10 gusht (ER) - Të hënën në Komunën e Obiliqit do të bëhet përurimi i ndërtesës së re të qendrës për pajisje me dokumente, ku përfshihet aplikimi dhe pajisja me letërnjoftim, patentë shofer dhe regjistrim të veturave. Po në këtë qendër do të vendoset edhe shërbimi i gjendjes civile. Në këtë ceremoni do të marrin pjesë ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi dhe kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi.

# SHQIPTAR APO KOSOVAR?



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Shqiptarët në Kosovë nuk kanë ndonjë teoricien që merret me teorinë e kombit në aspektin teorik e shkencor. Janë disa individë që kur flasin për kombin kosovar nisen nga teoria titiste për kombin, duke marrë si shembull kombin maqedon, i cili, në fakt, ishte dhe është komb bullgar. Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ), për t'i shkëputur maqedonët nga trungu bullgar e për ta bërë Maqedoninë pjesë të Federatës Jugosllave, bullgarët e Maqedonisë i emërton mbi bazën e emrit të vendit - komb maqedon!

Maqedonët, për ironi, vitet e fundit kanë bërë investime të mëdha në ndërtimin e përmendoreve të figurave të lavdishme të maqedonasve të vjetër, të cilët ishin ilirë, siç ishte Leka i Madh (Aleksandri i Maqedonisë). Ndërsa, në fakt, maqedonët janë bullgarë që në Maqedoni e Bullgari kanë ardhur në shekullin IX të erës sonë. Ndonjëri nga opinionistët si shembull i merr gjermanët dhe austriakët, të cilët janë dy kombe me një gjuhë të përbashkët. Në rastin e Kosovës, as kjo teori e ky krahasim nuk shkon.

Pse nuk shkon?

Austriakët dhe gjermanët janë dy kombe që flasin një gjuhë, fakt i pamohueshëm ky, por gjermanët dhe austriakët kur janë formuar si kombe, kanë qenë të ndarë në perandori të ndryshme. Në shekullin XIX, kur është bashkuar Gjermania e sotme (federale), Austria ka qenë si Perandori Austro-Hungareze (1867-1918). Ky fakt nuk mund të krahasohet me kombin shqiptar, i cili është formuar krejt ndryshe. Lëvizja politike gjithëshqiptare - Rilindja Kombëtare Shqiptare, kulmin e saj politik e kishte në pjesën e dytë të shekullit XIX. Dhe, jo vetëm kaq, por qendra e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në kulmin e saj siç ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si qendër kishte Kosovën dhe shumë udhëheqës të asaj lëvizjeje e kryengritjeje shtetformuese ishin pikërisht nga Kosova, si Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, Sef Kosharja, Mic Sokoli, Ramadan Zaskoci, Ali Pashë Gusia, Jakup Ferri, Haxhi Zeka etj. Pastaj, jo vetëm kaq, por edhe të gjitha kryengritjet shqiptare të fillimit të shekullit XX, sidomos ato të viteve 1910-1912 epiqendër kishin Kosovën dhe udhëheqës të kryengritjes së përgjithshme ishin Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi etj. Pra, shqiptarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë nuk mund të ndajnë asgjë. Nuk mund të ndajnë as gjuhën, as kulturën, as traditat e trashëguara ndër shekuj, as këngët e lindjes e të vdekjes, as të drejtën zakonore, as mitet e legjendat, as heronjtë e alfabetin. Shqiptarët e Kosovës e të Shqipërisë i ndajnë vetëm 87 vjetët e robërisë së shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Kosovës Lindore.

Të gjithë shqiptarët e dinë, siç e di e gjithë Evropa dhe evropianët, se ishin Fuqitë e Mëdha të Evropës që në korrik të vitit 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, e copëtuan kombin shqiptar dhe trojet e tij që banoheshin nga shqiptarët. Gjithashtu, të gjithë e dimë se të gjitha organizimet politike nga Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, e formuar në vitin 1918, kanë luftuar për çlirimin dhe bashkimin e shqiptarëve që konferenca e përmendur i kishte lënë jashtë shtetit shqiptar - Shqipërisë Londineze. Edhe Marti Ahtisari në një intervistë për televizionin publik RTK pati deklaruar se kishte për qëllim edhe të bënte korrigjimin e një padrejtësie historike që u ishte bërë shqiptarëve. Pse sot kemi dy shtete shqiptare, ky nuk ishte vullneti i shqiptarëve, ishin konjukturat e të fuqishmëve ato që vendosën që të mos kishte kthim para vitit 1999 dhe të mos kishte bashkim as me Serbinë e as me Shqipërinë. Prandaj tendencat e ndonjë poeti e matematikani për ta formuar kombin shqiptar janë tendenca primitive që nuk kanë mundur t'i jetësojë as sundimi gati njëshekullor serbo-jugosllav. Gjithashtu, tendenca për ta lidhur "kombin" e ri "kosovar" me një futbollist është një budallallëk më vete. Budallallëk që të çon te mjerimi i këshilltarëve të Qeverisë, e cila udhëhiqet, le ta themi hapur, nga komandantët që kanë luftuar për çlirimin e bashkimin e kombit shqiptar! Ky fenomen është vështirë i kuptueshëm se çfarë metamorfoze po zhvillohet te disa ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Është më shumë se e habitshme se si atë që nuk kanë mundur t'ia imponojnë armiqtë e egër popullit shqiptar, tentojnë t'ua imponojnë disa "intelektualë" mjeranë! Nuk kam asnjë dyshim, ky mjerim vjen nga gjendja e mjerueshme në arsimin shqip tash e tridhjetë vjet! Dhe vërtet është interesant, kombi shqiptar kurrë nuk ka pasur më shumë universitete publike e kolegje private dhe kurrë nuk ka pasur më shumë njerëz të padijshëm sesa ka sot.

Ky debat është më shumë sesa i shpifur. Pse është i tillë me bindin argumentet foshnjore që sollën opinionistët e gjithëdijshëm, siç ishte argumenti për kombin e ri, me ekzistencën e një futbollisti tani të ndjerë nga Kosova qe një kohë ka luajtur futboll në ekipet jugosllave. Mbase në demokraci secili e ka të drejtën të deklarohet se si ndihet?! Unë jam shqiptar, kosovar dhe drenicas.

Është interesant se si rrjedh ndryshimi sipas ndonjërit. Deri në mëngjesin e 17 shkurtit 2008 ishim shqiptarë, atë ditë, pas dite, pa e ditur as vetë, u bëmë kosovarë?! Interesant! Metamorfoza e disave, vërtet është për studim serioz!

# DY KADETË TË FSK-së DIPLOMOJNË NË BRITANI

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka marrë pjesë në ceremoninë e diplomimit të dy kadetëve të FSK-së, nëntogerëve Kemajl Haliti dhe Çlirim Morina. Të dy kadetët e FSK-së kanë përfunduar me sukses trajnimin dymbëdhjetëmujor, i cili ka qenë i bazuar në një program mjaft intensiv, me qëllim që t'i përgatisë oficerët e rinj që të jenë udhëheqës kompetentë, të aftë të marrin gjykime të drejta dhe t'i kryejnë detyrat në mënyrë profesionale.



Nëntogeri Kemajl Haliti është oficer i ri i FSK-së nga radhët e komunitetit rom që paraprakisht ka mbaruar shkollimin në Qendrën për Studime Universitare të FSK-së dhe ishte përzgjedhur për studime në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sundhurrst", mundësi kjo që aplikohet në barabarësi për të gjithë pjesëtarët e FSK-së.

Pas kthimit nga Mbretëria e Bashkuar, nëntogerët Haliti dhe Morina do të shërbejnë në FSK, me detyrë komandant togu, në Batalionin e Parë të Reagimit të Shpejtë në Gjilan, respektivisht në Batalionin e Dytë të Reagimit të Shpejtë në Istog.

Akademia Ushtarake Mbretërore Sandhurst vlerësohet si një ndër akademitë më prestigjioze në botë, nga e cila kanë dalë udhëheqësit më të suksesshëm ushtarakë nga mbarë bota. Çdo vit kjo akademi trajnon më shumë se 600 oficerë të rinj në kuadër të së cilës marrin pjesë edhe shtetet e tjera të botës, përfshirë këtu edhe Kosovën.

Forca e Sigurisë së Kosovës, bazuar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ushtrinë e Britanisë së Madhe, do t'i dërgojë kadetët e vet për shkollim në këtë akademi prestigjioze edhe në të ardhmen, me qëllim që me njohuritë e fituara të jenë kontribues në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve operacionale të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rraham Rama, ka përgëzuar nëntogerët Haliti dhe Morina për suksesin e arritur në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sundhurst" në Mbretërinë e Bashkuar, njëherësh ka kërkuar nga ta që njohuritë e fituara t'i zbatojnë me sukses në detyrat e reja në Forcën e Sigurisë të Kosovës.

## Presidenti i ri meksikan me qasje të re ndaj sigurisë



MEKSIKO SITI, 10 GUSHT - Presidenti i ri i Meksikës thotë se kur të fillojë nga detyra në muajin dhjetor, ai do të ketë një grup sigurie me persona të paarmatosur. Në përbërjen e këtij grupi do jenë 10 burra dhe 10 gra, në ndryshim nga presidenti Pena Nieto, që ka një numër të madh rojesh personale.
Andres Manuel Lopez Obrador foli për gazetarët të enjten, pasi u takua me presidentin në largim, Enrique Pena Nieto, lidhur me transferimin e pushtetit më 1 dhjetor.
"Do të kem një ekip prej 20 profesionistësh, jo medoemos të fushës së sigurisë, por ata do të jenë profesionistë: që të gjithë do të jenë me shkollë të lartë: 10 gra dhe 10 burra", tha presidenti i ardhshëm meksikan.
Lopez Obrador thotë se ekipi prej 20 vetash do të shërbejnë më tepër si ndihmës të tij, sesa si roja personale, duke shtuar se ai do të mbrohet nga të gjithë meksikanët - nga njerëzit e zakonshëm dhe nga ushtarët.
Në ndryshim prej tij, presidenti në largim Pena Nieto thuhet se mbrohet nga të paktën 2 mijë roja presidenciale të armatosura, të cilët janë planifikuar të punojnë në Ministrinë e Mbrojtjes, sapo të fillojë nga detyra presidenti Lopez Obrador.

# Moska paralajmëron hakmarrje ndaj sanksioneve amerikane

Mesazhi i ashpër i kryeministrit rus Dmitri Medvedev shënon atë që Kremlini e sheh si një vijë të kuqe, ndërkohë që sanksionet e reja amerikane kanë bërë që monedha ruse, Rubla, të bjerë në nivelin më të ulët në dy vjet




MOSKË, 10 GUSHT - Kryeministri rus Dmitri Medvedev paralajmëroi ashpër Shtetet e Bashkuara që të mos i shtojnë sanksionet, duke thënë se Moska do të hakmerret me mjete të tjera ekonomike dhe politike.
Ky mesazh i ashpër shënon atë që Kremlini e sheh si një vijë të kuqe, ndërkohë që sanksionet e reja amerikane kanë bërë që monedha ruse, Rubla, të bjerë në nivelin më të ulët në dy vjet.
Departamenti amerikan i Shtetit tha të mërkurën se Uashingtoni po i vendoste sanksionet për shkak të përdorimit nga Moska të agjentit nervor Novichok për të helmuar ish-spiunin rus Sergei Skripal dhe vajzën e tij në qytetin britanik Sollsbëri. Rusia i ka mohuar fuqimisht akuzat.
Rusia vazhdon të jetë nën sanksionet e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian që nga aneksimi i gadishullit ukrainas të Krimesë në vitin 2014. Humbjet ekonomike kanë qenë të konsiderueshme.
"Një shembull: kapitalizimi në treg i kompanisë më të madhe ruse, Rosneft, është rreth 60-70 miliardë dollarë në varësi të tregut. Ndërkohë, një kompani e krahasueshme amerikane si Exxon-Mobil ka një vlerë prej 350 miliardë dollarësh. Pra, diferenca është gjigante", thotë Dmitry Zhdannikov, editor burse i kompanisë Reuters.
Zëdhënësi i Kremlinit i siguroi rusët se sistemi financiar i vendit mbetet i qëndrueshëm.
Humbjet financiare nuk e kanë penguar presidentin rus Vladimir Putin që të ndërhyjë më tej në Ukrainën Lindore dhe në proceset politike të vendeve të tjera.
Ministria e Jashtme i quajti sanksionet e reja të ShBA-së një "ultimatum" të kotë. Disa analistë thonë se sanksionet nuk kanë sjellë deri tani rezultatet e dëshiruara.
"Perëndimi shpresonte se sa më shumë presion t'i bënte Putinit, aq më shumë do të rëndonin sanksionet, aq më e madhe do të ishte pakënaqësia midis elitës politike dhe biznesit rus dhe kjo do ta detyronte Putinin të ndryshonte. Por kjo nuk ndodhi gjatë katër viteve të fundit, në fakt kemi parë krejt të kundërtën", thotë Dmitry Zhdannikov.
Por ambasadori rus në ShBA e ka quajtur grupin e ri të sanksioneve "një masë drastike". Disa rusë shqetësohen se qytetarët e zakonshëm do të paguajnë çmimin.
"Kjo është një lojë e madhe, dhe ne njerëzit jemi thjesht gurë shahu. Nuk i dimë arsyet e vërteta, kështu që gjithçka që mund të bëjmë është të vëzhgojmë dhe të përpiqemi të mbijetojmë ose të ndryshojmë jetën tonë në një mënyrë që të mos ndikohet nga sanksionet ose nga influenca e huaj", thotë Aleksander Zimin, banor i Moskës.
Sanksionet e reja amerikane kundër Rusisë do të hyjnë në fuqi më 22 gusht në përputhje me ligjin amerikan për armët kimike dhe biologjike të ndaluara.

# Dëbimi i diplomatëve grekë nga Rusia, akt arbitrar



ATHINË, 10 GUSHT - Autoritetet greke thanë të premten se dëbimi nga Rusia i diplomatëve grekë ishte "arbitrar" dhe nuk bazohej në prova, pas një lëvizjeje të ngjashme nga Athina muajin e kaluar.
"Vendimi i palës ruse është arbitrar, hakmarrës dhe nuk bazohet në asnjë provë", thuhet në një deklaratë të Ministrisë së Jashtme greke.
"Duam t'u kujtojmë miqve tanë rusë se asnjë vend në botë nuk mund të tolerojë përpjekje për t'u dhënë ryshfet zyrtarëve shtetërorë, për të minuar politikën e jashtme dhe për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të tij", thuhej në njoftim.
Në muajin korrik Greqia dëboi dy diplomatë rusë dhe ndaloi dy qytetarë rusë të hyjnë në vend, të akuzuar për ndërhyrje në marrëdhëniet e tyre me Maqedoninë.
Sipas kanalit televiziv publik grek ERT1, Athina akuzonte zyrtarët rusë se po përpiqeshin të nxisnin protesta kundër një marrëveshjeje të kohëve të fundit me Shkupin, lidhur me emrin e ri zyrtar për Maqedoninë.

## Sulm me të shtëna në Kanada, disa persona të vdekur



OTAVA, 10 GUSHT - Policia kanadeze ka njoftuar për "disa viktima", si pasojë e të shtënave në qytetin lindor, Nju Brunsuik.
Të paktën katër persona janë raportuar të vdekur, pas incidentit në rrugën Brookside Drive.
Policia ka thënë se publiku duhet të qëndrojë larg zonës, derisa banorët janë këshilluar "të qëndrojnë në shtëpitë e tyre me dyer të mbyllura për shkaqe të sigurisë".
"Do të ofrojmë më shumë detaje shumë shpejt", ka deklaruar policia përmes një postimi në Twitter.

## Koreja e Veriut: ShBA-ja të ndalojnë skenarin e vjetër!



PHENIAN, 10 GUSHT - Koreja e Veriut ka sulmuar Shtetet e Bashkuara për vazhdimin e zbatimit të sanksioneve. Pheniani ka thënë se nuk mund të ketë përparim sa i përket denuklearizimit, nëse ShBA-ja vazhdon të veprojë sipas "skenarit të vjetër".
Koreano-veriorët, kanë akuzuar negociatorët amerikanë se janë duke marrë masa kundër qëllimeve të presidentit amerikan, Donald Trump dhe shpirtit të samitit të mbajtur në Singapor.
Trumpi dhe lideri Kim Jong-un janë pajtuar në muajin qershor se do të punojnë drejt denuklearizimit.
Mirëpo detajet deri më tani mbeten të paqarta, pasi Koreja e Veriut nuk ka treguar gatishmëri për të hequr dorë në mënyrë të njëanshme nga programi bërthamor, derisa Kombet e Bashkuara kanë thënë se programi bërthamor është duke vazhduar.
"Për aq kohë sa ShBA-ja kundërshton qasjet e mira për partnerin e saj të dialogut dhe vazhdon të veprojë sipas skenarit të vjetër, me të cilin kanë dështuar të gjitha administratat e kaluara, nuk mund të pritet ndonjë përparim apo zbatim të deklaratës së përbashkët duke përfshirë denuklearizimin", ka thënë Ministria e Jashtme koreano-veriore.

# FORCA JONË

* * * Viti VII • Nr. 71 • 8 Gusht 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës të Kosovës * * *

## Ministri Rrustem Berisha merr pjesë në konferencën e ministrave të mbrojtjes “SHBA-Karta e Adriatikut-A5” në Kroaci



Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), Rrustem Berisha, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, z. Damir Krstiçeviq, po merr pjesë në punimet e konferencës speciale “SHBA-Karta e Adriatikut A-5”, që po mbahet në Zagreb të Kroacisë.

Në këtë konferencë po merr pjesë sekretari i mbrojtjes i SHBA-ve, James Mattis, ministrat e mbrojtjes të Kroacisë, Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Qëllimi i mbajtjes së konferencës „SHBA-Karta e Adriatikut A5” është integrimi regjional, ballafaqimi me ndikimet e akterëve të jashtëm dhe ndarja e përgjegjësive dhe barrës. Delegacioni i Kosovës, me këtë rast e ka njoftuar sekretarin e mbrojtjes të SHBA-ve, James Mattis dhe të gjithë ministrat e mbrojtjes të regjionit, për të arriturat e FSK-së, ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin në aspektin profesional. Në këtë konferencë u kërkua që Kosova të jetë anëtare me të gjitha të drejtat e plota, si dhe Kosova ka ofruar gatishmërinë për të kontribuar në misione jashtë vendit. Gjithashtu me theks të veçantë u bisedua edhe tema e transformimit të FSK-së, në forca të armatosura, si kontribuuese e sigurisë në regjion dhe në botë përkrah partnereve tanë të sigurisë.




Nga të gjithë të pranishmit u kërkua, që i gjithë regjioni duhet të jetë bashkëpunues në ballafaqimin me kërcënimet bashkëkohore dhe të punojmë së bashku në ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta. Në veçanti u theksua që A5, duhet të zgjerohet edhe me shtete tjera të regjionit, duke e përfshirë edhe Kosovën si anëtare me të drejta të plota.

Gjatë konferencës ministri i FSK-së, Rrustem Berisha takoi sekretarin e mbrojtjes të SHBA-ve James Matis, po ashtu pati takime bilaterale edhe me ministrat e mbrojtjes të Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, ku u konfirmua shkallë e lartë e bashkëpunimit në mes të ministrive përkatëse. Konferenca speciale „SHBA-Karta e Adriatikut A5”, pritet që sot t’i përfundojë punimet.

## Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi



Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneralit Hulusi Akar, nga data 01-05 korrik 2018, qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama është pritur nga komandanti i Forcave të Armatosura të Turqisë, gjenerali Hulusi Akar, ku të dy gjeneralët gjatë takimit kanë biseduar për bashkëpunimin e deritashëm si dhe për mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen edhe në fushat tjera, si: shkollimit, edukimit dhe stërvitjeve, e që janë me interes të përbashkët.

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, pasi e ka falënderuar komandantin e Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneralin Akar, për mbështetjen e vazhdueshme të Ushtrisë së Turqisë në trajnimin dhe avancimin e FSK-së, si një forcë kredibile, gjithëpërfshirëse dhe të gatshme, si dhe për shkollimin e kadetëve në akademitë dhe shkollat ushtarake të Turqisë, e ka njoftuar edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si; shkollimet, trajnimet dhe bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar. Komandanti i FSK-së, gjatë qëndrimit në Turqi, realizoi vizitë zyrtare edhe në Universitetivn e Mbrojtjes së Turqisë, ku është pritur nga stafi i lartë i këtij institucioni ushtarak.

Gjenerali Rrahman Rama ka biseduar me udhëheqësit e Universitetit të Mbrojtjes për mundësinë e shkollimit dhe edukimit të pjesëtarëve të FSK-së, në këtë institucion ushtarak në të ardhmen, ku një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së, kanë diplomuar në këtë institucion ushtarak. Gjatë takimit u tha se bashkëpunimi i FSK-së me Forcat e Armatosura të Turqisë është shumë i mirë dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen duke përfshirë edhe fushat tjera që janë me interes të përgjithshëm për të dyja palët. Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, sot pritet ta përfundojë vizitën zyrtare në Republikën e Turqisë.

## FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane „Hamvi”

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në një ceremoni rasti, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve, z. Greg Delavie, më 17.07.2018, nënshkruan aktin final të kontratës për furnizim me automjete shumë funksionale ushtarake me lëvizshmëri të lartë (HMMWV) nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kompaninë amerikane „AM General” për furnizim të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është një trupë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe është shembulli më i mirë i ecjes së përbashkët të Kosovës me SHBA-të dhe NATO-n:

*vazhdon në faqen pesë*



*Deklaratë për media e ministrit Rrustem Berisha*

# FSK-ja ka qenë, është dhe do të jetë e hapur për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë



Forca e Sigurisë së Kosovës, ditëve të fundit është duke u përballur me dukurinë e kërkesave për largim nga FSK-ja të disa pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë serb. Sipas vlerësimeve të MFSK, këto kërkesa për largim vijnë si pasojë e sulmeve të qëllimshme që i janë bërë FSK-së, përkatësisht pjesëtarëve të komunitetit serb dhe janë tentim për të dëmtuar arritjet dhe zhvillimin e FSK-së si dhe imazhin e saj si institucioni më i besueshëm në vend për vite me radhë. Ne ndjejmë keqardhje për pjesëtarët tanë të cilët nuk janë lejuar të vendosin lirshëm për vazhdimin e karrierës profesionale, të ardhmes së tyre, duke ndikuar negativisht direkt në mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre.

Pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti serb kanë qenë shumë mirë të integruar në nivel të përgjegjësive dhe detyrave të tyre, prandaj shantazhet dhe kërcënimet e bëra janë të papranueshme, janë shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Diversiteti etnik dhe profesionalizmi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, është një vlerë që është e njohur dhe e pranueshme nga miqtë tanë ndërkombëtar dhe shtetet anëtare të NATO-s, dhe kjo vlerë është duke ju penguar atyre që nuk ja dojnë të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj, pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. FSK, do të vazhdojë në përmbushje të misionit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve operacionale si dhe angazhimin për përfundimin e tranzicionit në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK), si forcë moderne mbrojtëse për Kosovën dhe popullin e saj pa asnjë dallim.

Rruga e Kosovës dhe e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk do të ndalet. FSK-ja ka qenë, është dhe do të jetë e hapur për të gjitha komunitet që jetojnë në Kosovë dhe gjithherë do të jetë në shërbim të qytetarëve të saj.

## Gatishmëri e dyanshme për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe MM të Irlandës



Sot, (10.07.2018) ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha priti ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, z. Paul Kehoe. Në takimin e përbashkët në mes të dy delegacioneve, ministri Berisha së bashku me ministrin e Republikës së Irlandës, zotin Kehoe biseduan për bashkëpunimin e dyanshëm në mes të Kosovës dhe Republikës së Irlandës, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Irlandës si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Ministri Berisha, ka falënderuar ministrin e Irlandës Paul Kehoe për bashkëpunimin e deri tashëm dhe për ndihmën që Irlanda ka dhënë dhe po jep për Kosovën, duke e njoftuar me zhvillimet e përgjithshme në Ministri dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Pas takimit të dy ministrat dhanë nga një deklaratë për media.

Ministri Rrustem Berisha në fjalën e tij ndër të tjera tha: „Patëm nderin dhe kënaqësinë që ta presim ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Irlandës, z. Paul Kehoe të cilin e njoftuam në pika të shkurta me të arriturat e FSK-së, me progresin e FSK-së, sidomos me integrimin e komuniteteve jo shumicë, pjesëmarrjen e gjinisë femërore në strukturat e FSK-së, me objektivat dhe synimet tona si dhe me procesin e transformimit të FSK-së në FAK. Në të njëjtën kohë e falënderuam ministrin e mbrojtjes Kehoe, për mbështetjen dhe për përkrahjen që na kanë dhënë në rrugëtimin tonë drejt lirisë dhe sidomos pas luftës, e që vazhdojnë të japin edhe tani në kuadër të KFOR-it. Gjithashtu e falënderuam ministrin për faktin që Irlanda ka qenë ndër të parët që e ka njohur pavarësinë Kosovës.

Biseduam edhe për avancimin e bashkëpunimit të dy ministrive në fushën e sigurisë dhe për modelet e bashkëpunimit, dhe se shumë shpejtë do ta nënshkruajmë memorandumin e bashkëpunimit në mes të dy ministrive në fushën e sigurisë".

Ndërsa, ministri i Republikës së Irlandës Paul Kehoe falënderoi ministrin Berisha për pritjen e përzemërt dhe para mediave ndër të tjera deklaroi: „Jam i nderuar që jemi siç e përmendi ministri Berisha, ndër vendet e para që kemi njohur Pavarësinë e Kosovës. Është vizita e ime e parë në Kosovë, qëllimi i saj ishte vizita e pjesëtarëve të KFOR-it Irlandez, gjithashtu kam nderin që të jem këtu në mesin e juaj. Me ministrin biseduam për çështje të ndryshme siç është liberalizimi i vizave, integrimi në Bashkimin Evropian, në Kombet e Bashkuara etj. Ne do të ju afrojmë ndihmën tonë të pakursyer në këto procese, dhe do të jemi gjithmonë pranë jush posa t'i plotësoni kërkesat relevante.

Gjatë rrugëtimit e pashë që Kosova ka një të ardhme të ndritshme bazuar në progresin e bërë. Me ministrin biseduam edhe për avancimin e bashkëpunimit, veçanërisht në përgatitjen e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive". Në takim të pranishëm ishin edhe Shkëlzen Syla, sekretar i Përgjithshëm në MFSK, Jashar Ramadani shef i Kabinetit të Ministrit, majori Hisen Berisha këshilltar ushtarak i Ministrit, Zoja Lleshi-Berisha këshilltare politike e Ministrit, Ilir Murtezi këshilltar politik i Ministrit, Sinan Geci nga Departamenti për Bashkëpunim dhe Siguri, Ibrahim Shala Departamenti për Marrëdhënie me Publikun kurse nga delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Irlandës, ministrin e shoqëronin; Pat Kelly ambasadori i Irlandës, Maurice Quinn sekretar i Përgjithshëm, John Coughlan këshilltar i Ministrit, znj. Cliona O'Sullivan sekretare private e Ministrit, zv.admiral Mark Mellett shef i stafit në Ministrin e Mbrojtjes dhe Deirdre Carbery kapiten.

## Gjermania konfirmon mbështetjen për FSK-në dhe Kosovën



Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe koloneli Jeton Dreshaj, që nga data 16.07.2018, po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Qeverinë Federale të Gjermanisë.

Zëvendësministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama, gjatë vizitës në Qeverinë e Gjermanisë kanë realizuar takime të përbashkëta ku kanë biseduar për zhvillimet dhe arritjet e përgjithshme të FSK-së, avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, si dhe për planet për avancim dhe bashkëpunim në të ardhmen.

Gjatë takimeve të përbashkëta, zyrtarët e lartë të Qeverisë Gjermane kanë konfirmuar mbështetjen për FSK-në dhe Kosovën, duke përkrahur zhvillimin e kapaciteteve profesionale të institucioneve të Kosovës për siguri me qellim të thellimit të bashkëpunimit me Gjermaninë dhe NATO-n, në këtë aspekt. Delegacioni i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës (MFSK) është pritur nga sekretari i shtetit z. Thomas Silberhorn, zëvendësministër në Ministrinë Federale të Mbrojtjes, kurse dje delegacioni i MFSK-së është pritur nga znj. Betinna Cadenbach, drejtoreshë për Politikat e Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe drejtori për Planifikim në Ministrinë e Mbrojtjes, gjenerali Erhard Bühler Delegacioni ka vizituar edhe Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Gjatë takimeve në Qeverinë e Gjermanisë delegacioni i MFSK-së bisedoi me mikpritësit për avancimin dhe thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë dhe në këtë kuadër edhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës me Ushtrinë e Gjermanisë.

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

# Delegacioni i lartë i FSK-së vizitoi Ministrinë e Jashtme të Francës



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) z. Burim Ramadani, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe oficeri i lartë kolonel Jeton Dreshaj, më 19 korrik 2018, qëndruan për vizitë zyrtare në Republikën e Francës. Delegacioni i MFSK-së i shoqëruar edhe nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris, z. Qëndrim Gashi u prit nga z. Thomas Bertin, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës.

Në takimet që zhvilloi delegacioni i FSK-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të Francës, janë diskutuar arritjet e FSK-së, bashkëpunimi dypalësh dhe avancimi i marrëdhënieve ndërmjet dy ministrive. Zv. ministri Ramadani dhe gjeneral Rama në takimet e tyre me zyrtarët francez biseduan edhe për sigurinë në Kosovë dhe rajon, si dhe për të ardhmen e FSK-së dhe mundësitë që FSK-ja në të ardhmen të bëhet pjesë e Operacioneve Paqeruajtëse krahas ushtrive të vendeve të NATO-s. Në të gjitha takimet e delegacionit të MFSK-së me zyrtarët francez u arrit konstatimi se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Francës për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është kontribut për partneritetin e përgjithshëm midis dy vendeve si dhe për sigurinë rajonale dhe më gjerë.

# Shefi i Shtabit të KFOR-it, gjenerali Powell vizitoi KDS-në



Më 19 korrik 2018, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) gjeneral brigade Irfete Spahiu priti shefin e Shtabit të KFOR-it në Kosovë gjeneral brigade Lawrence Powell. Në takimin e përbashkët në mes të dy gjeneralëve u bisedua për bashkëpunimin e dyanshëm ndërmjet FSK-së dhe KFOR-it, me theks të veçantë për bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe shkëmbimit të përvojave. Gjeneral Spahiu dhe gjenerali Powell biseduan edhe për të arriturat e FSK-së dhe rolin e KDS-së në zhvillimin dhe profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe mundësitë e bashkëpunimit si brenda ashtu edhe me partnerët strategjikë, si dhe për objektivat për zhvillimin dhe avancimin e KDS-së në të ardhmen. Gjeneral Spahiu ka falënderuar gjeneralin Powell për bashkëpunimin e deritashëm dhe për ndihmën që KFOR-i ka dhënë dhe po jep për Kosovën si dhe kontributin në ndërtimin dhe zhvillimin e FSK-së, si me pajisje po ashtu edhe me trajnime. Ajo gjithashtu e njoftoi gjeneralin Powell edhe me zhvillimet e përgjithshme që janë duke ndodhur në KDS dhe synimet për të ardhmen. Takimi përfundoi me shkëmbimin e dhuratave mes gjeneralëve të cilët shprehën gatishmërinë që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në të ardhmen.

# Kosova dhe Italia thellojnë bashkëpunimin në siguri dhe mbrojtje

Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 24 korrik 2018, kanë qëndruar për vizitë dyditore në Romë. Delegacioni i MFSK-së është pritur nga niveli i lartë i Qeverisë italiane dhe Forcat e Armatosura të Italisë. Në takimin e zv. ministrit Ramadani dhe komandantit Rama me zëvendësministrin italian të Mbrojtjes, z. Raffaele Volpi, u diskutua për objektivat e Kosovës për anëtarësim në NATO, thellimin e bashkëpunimit dypalësh me Italinë, arritjet e FSK-së, planin gjithëpërfshirës për transformimin e FSK-së në ushtri, si dhe për vullnetin e Kosovës për t'i dërguar trupat e FSK-së në ndihmë të popujve në zona të ndryshme të krizave nëpër botë.
Gjithashtu, dje, më 23 korrik, delegacioni i MFSK-së është pritur nga nënadmirali Giuseppe Dragone, komandant i Shtabit të Përbashkët Italian të Operacioneve. Delegacioni i FSK-së me nënadmiralin Dragone kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit dhe angazhimet e përbashkëta ndërmjet Kosovës dhe Italisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe për gatishmërinë e Kosovës për të marrë pjesë në Operacione Paqeruajtëse nëpër botë krahas Forcave të Armatosura Italiane. Delegacioni i MFSK-së ka zhvilluar vizitë edhe në Ministrinë e Jashtme të Italisë me drejtorin për Ballkanin Perëndimor dhe drejtorin për NATO, ku ndër të tjera me zyrtarët e MPJ-së u diskutuan marrëdhëniet e Kosovës me Italinë dhe me NATO-n.



# Gjenerali Naim Haziri vizitoi Komandën e Mbështetjes të FA të Republikës së Shqipërisë



Bazuar në planin e bashkëpunimit dypalësh me Republikën e Shqipërisë dhe me ftesë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) komandanti i brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) gjeneral brigade Naim Haziri, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Brigadës së Mbështetjes Operacionale nënkolonel Sami Hajrullahu, shefi i G3 i kësaj brigade, major Astrit Halilaj, më 16 korrik 2018, zhvilluan një vizitë pune dyditore në Komandën Mbështetëse të FARSH. Në këtë vizitë gjeneral Haziri shoqërohej edhe nga atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës i akredituar në Tiranë, kolonel Bashkim Shillova. Gjeneral brigade Naim Haziri u prit nga komandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gasper Lala dhe shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse kolonel Beqir Tafili. Në takim u fokusuan në fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, përkatësisht BMO-së, për trajnim dhe stërvitje në fushën e operacioneve për emergjencat civile, në rast të katastrofave natyrore si: zjarrfikje, kërkim- shpëtim e deri në ndërtim të urave. Gjeneral Haziri po ashtu u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-s gjeneral brigade Bardhyl Kollqaku i cili solli në vëmendje kontributin e FSK-së për Shtetin Shqiptar sa herë që është kërkuar në rastet e katastrofave natyrore.
Gjeneral Haziri falënderoi gjeneral brigade Kollqaku si dhe komandantin e Komandës Mbështetëse dhe stafin e tij për pritjen e ngrohtë duke kërkuar që bashkëpunimi midis Brigadës së Mbështetjes Operacionale të FSK-së dhe Komandës Mbështetëse të FARSH-it të jetë i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Gjeneral Haziri tha se "FSK-ja tani dhe në të ardhmen do jetë prodhuese e sigurisë për vendin, rajonin dhe më gjerë. Ne ndihemi jashtëzakonisht mirë që si institucion i ri kemi arritur të japim diçka për ushtritë partnere në fushën e trajnimeve të kërkim- shpëtimit, gjë të cilën do vazhdojmë të ofrojmë edhe në të ardhmen përmes Qendrës së Kërkim-Shpëtimit në Regjimentin e Mbrojtjes Civile. Duke pasur parasysh kapacitet aktuale që kemi si njësi bazuar në mision dhe në bashkëpunim për forcimin e tyre, do të jemi në gjendje që në kohë sa më të shkurtër t'iu përgjigjemi kërkesave në shërbim të qytetarëve për të dy vendet".

*Krivollak - Maqedoni*

# Kadetët e FSK-së marrin pjesë në ushtrimin fushor "Kampi veror 2018" në Krivollak të Maqedonisë



Në poligonin stërvitor ushtarak në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, sot (06.07.2018) kadetët e shteteve pjesëmarrëse me sukses përfunduan operacionet përfundimtare në kuadër të ushtrimit 12 ditor „Kampi veror 2018'', ku krahas kadetëve të 11 shteteve si: SHBA-ja, Gjermania, Shqipëria, Maqedonia, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Kosova, Rumania, Norvegjia dhe kadetët e FSK-së, të cilët demonstruan me sukses aftësitë e tyre profesionale si dhe nivelin e gatishmërisë. Ushtrimin fushor të kadetëve „Kampi veror 2018'' e përcollën nga afër edhe gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, shef i Departamentit për Operacione në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), kolonel Mehmet Lladrovci zëvendës komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), kapiten Adem Preteni zëvendës komandant i Qendrës për Studime Universitare të FSK-së (QSU),etj. Me këtë rast, gjeneral Nazmi Brahimaj, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka përgëzuar të gjithë kadetët e FSK-së, pjesëmarrës në ushtrim për motivimin, disiplinën, profesionalizmin dhe ndërveprimin me kadetët në ambient ndërkombëtarë me të cilin këta kadetët do të stërviten dhe trajnohen edhe në të ardhmen.

Në ditën e fundit të ushtrimit fushor, kadetët e të gjitha vendeve pjesëmarrëse, gjatë demonstrimit, përbënin një batalion shumëkombësh që ishin të ngarkuar me detyra të operimit dhe realizimit të tyre në terren. Ushtarët dhe eprorët pjesëmarrës treguan një nivel të lartë të angazhimit, veprimit dhe koordinimit në mes tyre, duke vepruar si njësi unike në realizimin e detyrave të përcaktuara nga skenari i ushtrimit. Ushtrimi fushor "Kampi veror 2018" ka karakter ndërkombëtar dhe organizohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia Ushtarake e Maqedonisë, në të cilin për çdo vit po marrin pjesë kadetët e vende të ndryshme të rajonit e më gjerë, të menaxhuar nga instruktorë të NATO-s dhe të Partneritetit për Paqe (PFP). Kadetët e FSK-së, pjesëmarrës në "Kampin veror 2018", edhe këtë vit u dalluan me paraqitjen e tyre të shkëlqyeshme si në operacionet individuale dhe ato kolektive.



# Certifikohen zhytësit e FSK-së për kërkim-shpëtim në ujëra



Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim në Pomozatin, më 29.06.2018, është mbajtur ceremonia e certifikimit të 12 pjesëtarëve të FKS-së, të cilët kanë përfunduar me sukses kursin e nivelit bazik të zhytjes në ujë. Gjatë këtij trajnimi kadetët kanë përfunduar pjesën teorike brenda në klasë, ku kanë mësuar procedurat e sigurisë, njohuritë rreth pajisjeve të zhytjes dhe komunikimin nën ujë. Faza tjetër e trajnimit është mbajtur në pishinë, në Banjë të Malishevës, ku për herë të parë studentët kanë përjetuar përvojën praktike të veshjes si dhe notit me pajisje të zhytjes. Fazën e tretë dhe të fundit të trajnimit, studentët e kryen në Batllavë, gjatë qëndrimit njëjavor; ku aty studentët kanë fituar praktikën dhe përvojën e zhytjes në ujëra të ndotura ku shikueshmëria ka qenë shumë e dobët. Gjatë testimit të rreptë, studentët për detyrë kanë pasur kryerjen e një numri të procedurave të sigurisë gjersa zhyteshin në një thellësi minimale prej 5m nën ujë. Gjatë testimit, studentët u vizituan nga admirali Kilrain i SHBA-ve dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Certifikatat janë ndarë nga koloneli Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), koloneli Selim Troci nga Ushtria e Republikës së Shqipërisë dhe njëherësh drejtor i Qendrës së Kërkim-Shpëtimit, Major Connor, Atasheu nga Ambasada e SHBA-ve si dhe drejtori i Qendrën së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim. Ky kurs ka qenë historik për tërë FSK-në. Për herë të parë, nga komuniteti joshumicë, 2 pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb janë kualifikuar si zhytës. Gjithashtu për herë të parë, duke u ballafaquar me stresin mendor dhe tendosjen e të qenit anëtar i kërkim-shpëtimit profesional si dhe një zhytës, studentët iu nënshtruan një trajnimi specifik lidhur me atë se si të menaxhojnë traumat psikologjike. Ky modul u tregua shumë i suksesshëm andaj që prej tash është përfshirë në të gjitha kurset që ofrohen nga QTKSH-ja.

Në përmbushjen e detyrave të tij, sa të ndjeshme po aq edhe fisnik. " Nderimi ndaj historisë, dëshmorëve dhe të kaluarës sonë të lavdishme është nderim për



lirinë, shtetin e Kosovës dhe të ardhmes tonë. Kjo uniformë që sot bartin vajzat dhe djemtë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka kaluar një rrugë të gjatë e të mundimshme për të ardhur deri këtu ku jemi sot, andaj çdo angazhim yni për të ndihmuar në projektet tuaja për komplekset memoriale në Kosovë, është një nder për ne". Ndërkaq, drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Bislim Zogaj e falënderoi përzemërsisht ministrin Berisha për pritjen dhe përkrahjen.



## Albian Ajvazi shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar në shkollën e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve

Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, togeri Albian Ajvazi, këshilltar ushtarak i komandantit të Forcës Tokësore të FSK-së, më 20.07.2018, shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, në trajnimin "Kursi për Kapiten të Karrierës për Adjutant Gjeneral" që u realizua nga shkolla e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve. Në këtë shkollë, përveç studentëve nga ushtria amerikane, pjesëmarrës ishin edhe oficerë nga Kosova, Egjipti, Jordania, Indonezia dhe Rumania. Në vlerësimin e përgjithshëm nga ushtria amerikane shkruhet: Togeri Albion Ajvazi demonstroi një kuptim të plotë të kompetencave të burimeve njerëzore, si dhe funksioneve të tjera thelbësore të mbështetjes së burimeve njerëzore. Ai e përfaqësoi Kosovën në mënyrë të jashtëzakonshme në Shtetet e Bashkuara. Toger Ajvazi, gjatë shkollimit në SHBA, ka zgjeruar njohuritë ushtarake në temat e përgjithshme si:

Menaxhimi i sistemeve të burimeve njerëzore; mbështetja operacionale dhe taktike; shërbimet esenciale dhe menaxhimi i gatishmërisë së personelit; zhvillimi i planifikimit dhe operacioneve në kuadër të burimeve njerëzore dhe mbështetja civile në operacione. Togeri i FSK-së, Albian Ajvazi, në shkollën e Adjutantëve Gjeneralë të Ushtrisë së SHBA-ve arriti rezultate të shkëlqyeshme dhe si rezultat i performancës së lartë, pas përfundimit të trajnimit, u dekorua me medaljen „Diplomatic Award" për periudhën kohore janar-korrik 2018.

# FSK-ja pajiset me automjete taktike amerikane „Hamvi”

*Vijon nga faqja e parë*







Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në një ceremoni rasti, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe ambasadori i SHBA-ve, z. Greg Delavie, më 17.07.2018, nënshkruan aktin final të kontratës për furnizim me automjete shumë funksionale ushtarake me lëvizshmëri të lartë (HMMWV) nga Qeveria e Republikës së Kosovës me kompaninë amerikane „AM General” për furnizim të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është një trupë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe është shembulli më i mirë i ecjes së përbashkët të Kosovës me SHBA-të dhe NATO-n: „Sot, ne po bëhemi dëshmitarë të një ngjarjeje të madhe për popullin e Kosovës. Forca jonë e sigurisë po modernizohet me teknikë ushtarake shumë funksionale “Hamvi”. Ngritja e kapaciteteve teknike të FSK-së dita-ditës tregon se kjo forcë po ngritët sipas standardeve të NATO-s”. Më tej, kryeministri Haradinaj theksoi: „SHBA-të, NATO-ja, KFOR-i dhe Bondstilli janë sinonime të qetësisë e sigurisë në Kosovë, dhe nuk është habi që populli i Kosovës është ndër popujt më pro amerikanë që i qëndron besnik miqësisë së përhershme me SHBA-të”. Në fund të fjalës së tij, i pari i Qeverisë së Kosovës, z. Haradinaj tha: „Kosova është rreshtuar me ushtritë e lirisë dhe të paqes. Tranzicioni i FSK-së do të bëhet në koordinim të plotë dhe me mbështetjen e aleatëve tanë strategjikë. Kosova nga një vend që absorbon siguri po kthehet në një vend që prodhon dhe ofron siguri dhe është e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse, kudo që aleatët tanë e shohin të nevojshme”.

Ndërsa, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha tha: „Sot, është një ditë e veçantë për mua, Ministrinë dhe FSK-në. Mjetet taktike „Hamvi” do të jenë në shërbim të FSK-së, dhe ky akt i nënshkrimit është i një rëndësie të veçantë që i kontribuon thellimit të bashkëpunimit me SHBA-të, avancimit të FSK-së, si dhe rrit shkallën e ndërveprueshmërisë me shtetet e NATO-s.”. Në fund të fjalës së tij, ministri Berisha tha: „Dua të falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e pakursyer në vazhdimësi e sidomos në kuadër të trajnimeve, edukimit apo edhe pajisjeve përmes Zyrës për Bashkëpunim Ushtarak (ODC) dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, dhe ky bashkëpunim do të vijojë edhe më tej në të ardhmen”.

Nga ana e tij, ambasadori amerikan, z. Greg Delavie tha se: „Sot po kremtojmë nënshkrimin e kontratës për furnizim ndërmjet FSK-së dhe kompanisë „AM General” dhe se më vjen mirë që Forca e Sigurisë së Kosovës e ka përzgjedhur Hamv-në si automjetin e ardhshëm të saj. Kjo kontratë i dërgon shenjë të qartë botës se Kosova mëton ta çojë deri në fund integrimin euroatlantik në të gjitha mënyrat. Kjo blerje do ta forcojë partneritetin ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të ndihmojë në përmbushjen e ndërveprueshmërisë në mes të forcave ushtarake amerikane, NATO-s dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, jemi të ngazëllyer që jemi pjesë e kësaj ere të re të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe presim me padurim ta shohim dërgesën e parë të Hamvi-ve gjatë këtij viti”.

Kurse, nënkryetari i kompanisë „AM General” z. Lawrance Platt, falënderoi Qeverinë e Kosovës dhe FSK-në për besueshmërinë për furnizimin me automjetet të Kompanisë, ashtu siç ka bërë ushtria amerikane dhe shumë shtete të NATO-s. Në ceremoninë e organizuar nga Qeveria e Kosovës të pranishëm ishin edhe ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha, sekretari i përgjithshëm z. Shkelzen Sylaj, komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral major Gëzim Hazrolli, nën-presidenti ekzekutiv i kompanisë “AM Generals”, z. Lawrance Platt, komandanti i KFOR-it gjeneral major Salvatore Cuoci, komandant i Kampit Bondsteell kolonel Nick Ducich, gjeneralë të FSK-së, ministra, ambasadorë dhe atashe ushtarakë të akredituar në Kosovë, si dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.



# Ambasada Amerikane ndanë mirënjohje për ekipin e FSK-së që ofroi ndihmën e parë mjekësore të lënduarve në aksident komunikacioni



Me një ceremoni modeste në mjediset e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, mbajtur më 3 korrik 2018, atasheu ushtarak kolonel Jeffrey Fischer, në emër të ambasadorit amerikan në Kosovë, z. Greg Delavie, ndau nga një certifikatë-mirënjohje për katër ushtarakët e FSK-së, pjesë e ekipit të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave, të cilët treguan gatishmëri, vetëmohim dhe profesionalizëm në ofrimin e ndihmës së parë mjekësore për disa qytetarë të lënduar si pasojë e aksidentit në komunikacion. Me këtë rast, përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane, atasheu ushtarak, kolonel Jeffrey Fischer, në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke ua dorëzuar mirënjohjet për shërbim të jashtëzakonshme majorit Ali Vishit, tetarëve Arban Rushiti, Alban Shyti si dhe ushtarit Predrag Maksimoviç, në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi për punën dhe angazhimin e tyre në aksionin e ndërmarrë me vetiniciativë, në përgjigje të situatës-dhënie e ndihmës së parë në vend incident, theksoi që stafi i Ambasadës Amerikane edhe FSK-ja janë krenarë me aksionin e pjesëtarëve të FSK-së, si dhe theksoi se të gjithë këta janë duke punuar bashkë, çdo ditë e më shumë për një FSK edhe më të fuqishme dhe më profesionale. Ndërsa, gjeneral major Gëzim Hazrolli, drejtor i Drejtorisë për Operacione, në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, duke iu drejtuar të dekoruarve, e vlerësoi lartë iniciativën e kolonelit Fischer, në emër të ambasadorit, për ta vlerësuar punën dhe angazhimin e pjesëtarëve tanë. Ky akt, tha gjeneral Hazrolli është edhe një dëshmi tjetër se mbështetjen dhe përkrahjen e partnerëve tanë jemi duke e vënë në jetë konkretisht.

„Për me qenë hero nuk duhet që patjetër me ndodhë një emergjencë me përmasa të mëdha, nuk duhet që edhe me patjetër të ndodhë luftë, heronjtë janë edhe të paqes, dhe shpëtimi i një jete është gjithmonë një akt që duhet vlerësuar’’, tha gjeneral major Gëzim Hazrolli. Me këtë rast, udhëheqësi i ekipit të FSK-së, major Ali Vishi, falënderoi Ambasadën Amerikane për vlerësimin si dhe paraqiti një ekspoze të aksionit, ku foli për gatishmërinë dhe vetëmohimin e pjesëtarëve të ekipit të tij në përgjigje të situatës së shkaktuar nga aksidenti ndërmjet veturave civile, në aksin rrugor Prishtinë–Ranillug, derisa ekipi i FSK-së ishte caktuar të marrë pjesë në takimin për siguri në Komunën e Ranillugut. Gjithashtu, major Vishi e vlerësoi lart edhe angazhimin e Ambasadës Amerikane në kujdesin dhe mbështetjen me trajnime të pjesëtarëve të FSK-së, sidomos me trajnimet mjekësore, të cilat u vunë në jetë në rastin konkret.

Certifikata e mirënjohjes për katër pjesëtarët e FSK-së, të Njësisë për Reagim në Kriza, e dhuruar sot nga koloneli Fischer në emër të SHBA-ve, ka këtë motivacion: „Në shenjë mirënjohjeje për reagimin tuaj me vetiniciativë, në përgjigje të situatës nga aksidenti rrugor, Ju demonstruat përkushtim dhe profesionalizëm si pjesëtarë të Njësisë Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave. Reagimi juaj reflekton sukses për ju, FSK-në dhe Kosovën në përgjithësi’’.



# Ministri Berisha dhe gjeneral Rama pritën në takim lamtumirës atasheun ushtarak shqiptar, kolonel Ahmet Leka





Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës(MFSK)z. Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, më 26 korrik 2018, pritën në takime të ndara atasheun ushtarak shqiptar, kolonel Ahmet Leka, me rastin e përfundimit të misionit të tij. Ministri Berisha dhe komandanti Rama falënderuan kolonelin Leka dhe përmes tij Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për kontributin e tyre të madh në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në shumë fusha.

Në shenjë falënderimi, ministri Berisha kolonelit Leka i dhuroi Mirënjohje për angazhimin e tij në avancimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Më këtë rast, ministri Berisha u shpreh: "Ju falënderoj për bashkëpunimin korrekt dhe frytdhënës e mbi të gjitha vëllazëror gjatë mandatit Tuaj si Atashe i Shqipërisë në Kosovë.

Ndihma Juaj dhe e Shtetit shqiptar kanë një domethënie të veçantë për ne. Më lejoni që në emër të Ministrisë që drejtoj, në emër të FSK-së dhe në emrin tim personal, të ju falënderoj për kontributin Tuaj, në fusha të ndryshme, në Forcën e Sigurisë të Kosovës," tha ministri Berisha. Atasheu Ushtarak i Republikës së Shqipërisë, kolonel Ahmet Leka, është shprehur falënderues për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve gjatë ushtrimit të mandatit të tij në Kosovë. "Kam pasur fat dhe privilegj të punoj me Ju ministër Berisha. Jam ndier shumë i vlerësuar dhe i motivuar në detyrën time. Padyshim kjo është periudha më e mirë e karrierës time, pasi më mundësoj të kontribuoj për Ju, për vëllezërit e mi, duke realizuar kështu një ëndërr fëmijërie. Duke njohur angazhimin tuaj, potencialet dhe përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen e vlerave të ushtarakëve të Kosovës, jam i bindur se janë garancia më e mirë për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, përkatësisht transformimin e FSK-së në FAK", është shprehur kolonel Leka.

# Oficerë dhe familjarë të Forcave të Armatosura të Turqisë vizitojnë Kosovën

Bazuar në Protokollin mbi shkëmbimin e personelit ushtarak dhe civil për qëllime sociale dhe kulturore ndërmjet Ministrisë për FSK-në dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, prej datës 26 qershor deri më 02 korrik 2018, si mysafirë të MFSK/FSK-së ka qëndruar për vizitë kulturore në vendin tonë një delegacion 10 anëtarësh nga stafi ushtarak i Forcave të Armatosura të Turqisë me bashkëshortet e tyre. Delegacioni nga Turqia është pritur edhe nga komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe nga oficerë tjerë të FSK-së, disa nga të cilët shoqëruan delegacionin gjatë tërë kohës së qëndrimit në Kosovë. Mysafirët nga Forcat e Armatosura të Turqisë kanë realizuar edhe vizita të shumta nëpër vende të ndryshme historike dhe me interes kulturor si në Kosovë, Maqedoni dhe në Shqipëri. Në Kosovë kanë vizituar Muzeun Kombëtar, Xhaminë e Madhe, Ministrinë për FSK-në, Kazermën "Adem Jashari", Sheshin "Nëna Terezë", vendqëndrimin e stafit të KFOR-it turk në "Film City", Tyrben e Sulltan Muratit, Kompleksin Memorial të Jasharajve në Prekaz, Sheshin e Pejës, tek busti i Shkelzen Haradinajt vunë buqeta lulesh dhe nderuan me minutë heshtje dhe burimin e Drinit të Bardhë në Radavc të Pejës. Po ashtu në qytetin e Prizrenit përveç shumë objekteve me rëndësi kulturore dhe historike, vizituan Muzeun Etnologjik dhe atë Arkeologjik si dhe kampin e KFOR-it turk, ku u pritën nga stafi komandues i tij. Ndërkaq, në Shkup e Tiranë ata vizituan kanionin e Matkës, kalanë e Shkupit, xhaminë e Mustafë Pashës, Pazarin e Vjetër, Sheshin e Shkupit, Bunkerin Art, Xhaminë e Ethem Beut, Bulevardin "Nënë Tereza", Sheshin "Skënderbeu", Malin e Dajtit etj. Vizita është realizuar sipas agjendës së paracaktuar dhe mysafirët u shprehën mjaft të kënaqur me mbresa të veçanta dhe shumë falënderues për pritjen.



# Gjeneral Naim Haziri vizitoi operacionet e çminimit në terren



Komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, i shoqëruar edhe nga kolonel Esercito Terebinito, këshilltar i komandantit të FSK-së, nënkolonel Paul Stainthorpe, këshilltari i komandantit të FSK-së, major Christopher Donor, atashe ushtarak i SHBA-ve, si dhe kolonel Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtës Civile (RMC), më 27 korrik 2018, vizituan ekipet e deminimit të FSK-së, të cilat janë duke zhvilluar operacione çminimi në Parkun e Lirisë në Ferizaj dhe në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Gjeneral Haziri, gjatë këtyre vizitave, nga pjesëtarët e Kompanisë së Deminimit, u njoh nga afër me fushëveprimin dhe ecurinë e operacioneve të çminimit në zonat e minuara. Naim Haziri i përgëzoi pjesëtarët e ekipeve të Kompanisë së Deminimit për suksesin dhe profesionalizmin që kanë treguar, pa pësuar as edhe një dëmtim gjatë punës së tyre mjaft të rrezikshme, tash e sa vite kudo që kanë vepruan në Kosovë. Ai gjithashtu i ka inkurajuar ekipet e deminimit që edhe në të ardhmen të vazhdojnë me pastrimin e tokave të minuara, për të mbrojtur kështu jetën e qytetarëve të vendit. Në fund, për mysafirët, ekipet e Kompanisë së Deminimit prezantuan pajiset e punës dhe demonstruan në praktikë punën e tyre në pastrimin e terrenit.

# Oficerët e FSK-së përfundojnë Kursin e Lartë të Oficerit në Republikën e Shqipërisë



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), më 2 korrik 2018, diplomuan kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) dhe kursantet e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm(KKSHP). Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë një delegacion i Forcë së Sigurisë së Kosovës i udhëhequr nga gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe atasheu ushtarak, kolonel Bashkim Shillova, ndërsa nga FARSH ishte edhe gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, shef i Shtabit të FARSH. etj. Në këto kurse, për vitin akademik 2017-2018, shkollimin e vijuan gjashtë pjesëtarë të FSK-së. Kursin e Lartë të Oficerit e ka mbaruar një pjesëtar ndërsa, pesë të tjerë në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Pjesëtarët të cilët me sukses përfunduan këto kurse janë: Nënkolonel Bekim Zejnullahu, përfundoi (KLO) dhe ku mori mirënjohje për rezultatet e treguara gjatë këtij viti, gjithashtu edhe major Adem Shyti, mori mirënjohje për rezultatet e treguara në këtë kurs, si dhe diplomuan edhe major Adem Shyti, major Ibrahim Revuqi, major Agim Beqiri, major Astrit Halilaj dhe major Demë Lulaj.

# Batalioni i Tretë i BRSH-së përfundoi trajnimin „Komando dhe Bjeshkatari”



Në ambientet e Batalionit të Tretë të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Mitrovicë, dje ( 16.07.2018) është mbajtur ceremonia e certifikimit të 20 pjesëtarëve të cilët përfunduan me sukses trajnimin ,,Komando dhe Bjeshkatari”. Ky trajnim ka filluar më 04.06.2018 dhe ka përfunduar më 13.07.2018. Ligjëruesit, mbikëqyrësit dhe vlerësuesit të këtij trajnimi ishin nga Ekipi Trajnues Turk i cili në fund u nda i kënaqur me arritjet, përgatitjen dhe disiplinën e pjesëtarëve të FSK-së, që morën pjesë në trajnim. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë pjesëtarë të Kompanisë 3A, 3B dhe 3C. Trajnimi ka zgjatur gjashtë javë - katër javë janë mbajtur në kazermën ,,Minatori” në Mitrovicë dhe dy javë në kazermën e Regjimentit të Mbështetjes Civile ,,Evropianët e Rinjtë” në Pomozotin. Gjatë kësaj kohe të trajnimit janë realizuar ligjërata të kombinuara teorike dhe praktike në terren, të përcjella me teste me shkrim dhe ushtime praktike. Programi i trajnimit ,,Komando dhe Bjeshkatari” përfshinë temat e navigimit tokësor- ditën dhe natën; kalimin e poligonit të kalitjes; taktikat e qitjes me avancim individual në qifte, me skuadër dhe me togë; lëvizjet taktike individuale, ekip, skuadër dhe togë; repelimi nga vende kodrinore-malore dhe aktivitete sfiduese fizike, përfshirë marshime të vazhdueshme në distanca të gjata dhe vrapim me pajisje ushtarake deri në 27 km.

Në ceremoni të certifikimit, të pranishëm ishin zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Xhevahir Geci, zv. komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë kolonel Hysen Dreshaj, komandanti i Batalionit të Tretë, nënkolonel Sylejman Cakaj dhe koloneli i Ekipi Trajnues Turk Kemal Olçar. Nënkoloneli Sylejman Cakaj-komandant i Batalionit të Tretë, në adresimin e tij para të pranishmëve theksoi rëndësinë e arritjes së objektivave trajnuese të këtij trajnimi dhe njëherësh falënderoi Ekipin Trajnues Turk, për kontributin e dhënë në realizimin e këtyre objektivave. Ndërsa, zv. komandanti i Forcave Tokësore, gjenerali Xhevahir Geci, në fjalën e tij, përgëzoi komandantin e Batalionit të Tretë për të arriturat e përgjithshme dhe falënderoi Ekipin Trajnues nga Turqia për kontributin e dhënë në trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, e në veçanti pjesëtarët e BAT-3. Ky trajnim ishte një ndër trajnimet më sfiduese që kanë zhvilluar pjesëtarët e Batalionit të Tretë si dhe trajnimi i parë i këtij lloji që është mbajtur në FSK. Trajnimi ‘Komando dhe Bjeshkatari” tregon edhe një herë se Batalioni i 3-të është i gatshëm dhe ka kapacitete që të zhvillojë operacione për t’ju dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës në zonën e tij të përgjegjësisë. Në përfundim të kësaj ceremonie u ndanë certifikata për pjesëmarrësit në trajnim dhe instruktorët turq.

# Pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi, instruktore e fitnesit fizik në Mbretërinë e Bashkuar



Falë bashkëpunimit intensiv dhe shumë të suksesshëm ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës/ Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi u ftua përsëri në Shkollën e Ushtrisë së Trajnimit Fizik si instruktore për një shtojcë dyvjeçare. Kjo kontratë është e para e këtij lloji për FSK-në, e cila flet për besimin që Ushtria britanike ka në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët e saj, konkretisht në Gentiana Korpuzin, dhe që shërben gjithashtu për të thelluar lidhjet historike të FSK-së dhe Kosovës me Ushtrinë britanike. Pjesëtare Gentiana Korpuzi, pas shkollimit dyvjeçar parashihet që të kthehet përsëri dhe të investojë në FSK, në mënyrë që aftësitë dhe përvojën e fituar në Britani të Madhe t’i aplikojë në praktikë në FSK. Gentiana është pjesë e një gjenerate të re në FSK, e cila sjell njohuritë, aftësitë dhe përvojën nga trajnimet jashtë vendit në FSK dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në bërjen e saj më të përshtatshëm, më të shëndetshëm dhe më operative. Ajo në kohët e fundit ka organizuar dhe udhëhequr një Kurs instruktori të trajnimit fizik të FSK-së në Qendrën e Trajnimit dhe Doktrinës së FSK-së në Ferizaj. 20 të diplomuarit në Kursin për instruktorë të fitnesit fizik janë kthyer nëpër njësitë e tyre për të çuar përpara zhvillimin fizik dhe trajnimin në palestër. Gentiana Korpuzi si instruktore e fitnesit fizik gjithashtu ka udhëhequr aktivitetet fizike me rastin e përzgjedhjes së pjesëtarit të fundit të FSK-së për akademitë e Mbretërisë së Bashkuar. Pjesëtarja e FSK-së, Gentiana Korpuzi ka përfunduar për 9 muaj studimet në Shkollën e Armatës Britanike të Trajnimit Fizik



duke zhvilluar teknikat dhe teorinë fizike. Ajo gjithashtu është femra e parë që mbikëqyr që ka përfunduar një nga kurset fizike më prestigjioze që ushtron Ushtria britanike.

# Certifikohen pjesëtarët e FSK-së në Kursin për mbijetesë në ujëra



Në Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së, në Pomozatin, më 17.07.2018, është mbajtur ceremonia e certifikimit të tetë pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë përfunduar me sukses Kursin e parë një javor të mbijetesës në ujë të mbajtur për herë të parë në FSK. Ky kurs është zhvilluar bazuar në nevojat operacionale të nxjerra nga përvojat reale të pjesëtarëve të përfshirë në detyrat e kërkimshpëtimit. Materiali bazë i këtij trajnimi ka qenë Broshura e trajnimit për mbijetesë në ujëra e Ushtrisë Amerikane. Instruktorët e QTKSH-së përdorën këtë broshurë dhe e kombinuan me përvojat e tyre personale nga operacionet reale të kërkim-shpëtimit në lumenjtë dhe liqenet e Kosovës, si dhe zhvilluan një planprogram mësimor specifik për mjedisin e Kosovës. Duke qenë hera e parë e mbajtjes së këtij kursi nga QT-ja, pjesëmarrës kanë qenë vetëm pjesëtarët e FSK-së të cilët janë aktualisht zhytës. Studentët janë trajnuar rreth ndihmës së parë mjekësore, si reagues të parë dhe si ta shpëtojnë dikë që gjendet në vështirësi në ujë. Ata kanë mësuar si të krijojnë pajisje lundrimi nga gjësendet që kanë përreth, si dhe kanë mësuar si të krijojnë dhe të përdorin litarët për të shpëtuar viktimat. Kjo përfshin gjithashtu përdorimin e uniformës, rripit apo edhe lidhëseve të këpucëve. Studentët gjithashtu kanë lundruar nëpër lumenj në një gjatësi prej 2km për të gjetur viktimat në ujë. Duke marrë parasysh se trajnimi është zhvilluar ditën dhe natën, pjesa më e vështirë ka qenë përfundimi i notit prej 1,5km në liqenin e Batllavës, duke bartur me vete kowmplet uniformën derisa mbështeteshin vetëm në një pjesë druri për të evituar fundosjen në ujë. Trajnimi për mbijetesën në ujë tani do të vlerësohet nga stafi i QT-së dhe modifikimet e nevojshme do të bëhen në të ardhmen, për të siguruar që programi të japë plotësisht atë që është e nevojshme për FSK-në që të ndihmojë në mënyrë të sigurt autoritetet civile.



# Pjesëtarë të FSK-së, certifikohen për instruktorë të fitnesit fizik

Sot në mjediset e kazermës “Skënderbeu” të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes të FSK-së, në Ferizaj, më 19.07.2018, u mbajt ceremonia e certifikimit të trajnimit pesë-javor për instruktorë të fitnesit fizik i cili u realizua nga instruktorët e FSK-së. Në ceremoninë e certifikimit ishin të pranishëm komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale gjeneral brigade Naim Haziri, këshilltari i komandantit të FSK-së koloneli Sainthrope, zv. komandanti i Komandës së



Doktrinës dhe Stërvitjes koloneli Mehmet Lladrovci, shefi i Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes koloneli Gyrner Murati, përfaqësues të federatave të Kosovës, përfaqësues të Policisë së Kosovës, familjarë të kursantëve si dhe oficerë dhe pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së. Komandanti i Qendrës së Stërvitjes Specialistike, majori Ilmi Ramusholli, foli me hollësi rreth këtij trajnimi të realizua nga instruktorët e FSK-së, të cilët janë certifikuar nga Ushtria e Mbretërisë së Bashkuar. Ndërsa, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, falënderoi instruktorët dhe kursantët për angazhimin dhe përkushtimin e tyre gjatë realizimit të Kursit të fitnesit fizik, duke i marrë si shembull për disiplinën e treguar dhe rezultatet e arritura. Programi i fitnesit fizik për instruktor është përshtatur me nevojat e FSK-së dhe është duke funksionuar në mënyrë të shkëlqyeshme, falë punës së palodhshme të instruktorëve të FSK-së dhe mbështetjes së vazhdueshme të instruktorëve nga Mbretëria e Bashkuar. Kursin për instruktorë të fitnesit fizik e kanë përfunduar me sukses 20 pjesëmarrës nga të gjitha njësitë e FSK-së. Ata gjatë ceremonisë përmbyllëse demonstruan edhe disa nga njohuritë e fituara gjatë këtij kursi. Në fund u ndanë certifikata për kursantët dhe mirënjohje për më të dalluarit.

# Varroset me nderime të larta ushtarake kapiteni i FSK-së, Sejdi Krasniqi



Në Landovicë të Prizrenit, 16 korrik 2018, u varros me nderime të larta ushtarake kapiten Sejdi Krasniqi, komandant i Kompanisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, i cili të dielën, pas një sëmundje të rëndë ndërroi jetë. Për t’i dhënë lamtumirën e fundit kapiten Sejdi Krasniqit nga Ministria e FSK-së ishte sekretari i përgjithshëm Shkelzen Sylaj, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneralmajori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Xhevahir Geci, gjeneral brigade Naim Haziri si dhe oficerë dhe zyrtarë të lartë të FSK-së dhe MFSK-së.



Në akademinë përkujtimore ku ishin të pranishëm personalitete shtetërore, politike, ushtarake dhe qytetarë të shumtë, në emër të FSK-së, foli komandanti i Forcave Tokësore gjenerali Enver Cikaqi. Ai në fillim i shprehu ngushëllime familjes, pjesëtarëve të FSK-së, shokëve dhe kolegëve dhe më pas foli për jetën dhe veprën e kapiten Krasniqit, duke thënë nder të tjera: „E nderuar familje e kapiten Sejdi Krasniqit, më lejoni që në emër të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së dhe të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Ramës të shpreh konsideratën time më të lartë për veprën e madhe dhe shumë të rëndësishme për vendin në përgjithësi dhe për institucionin e FSK-së, në veçanti të oficerit, të bashkëluftëtarit, të mikut tonë-komandant Sejdi Krasniqit. Ai rrjedhë nga një familje patriotike që i kishte dhënë vendit në periudha të ndryshme të historisë sonë shumë veprimtarë e luftëtarë. Kishte filluar aktivitetin e tij patriotik si i ri dhe duke vazhduar në etapa të ndryshme të jetës, në organizime të shumta patriotike duke kulmuar edhe me përfshirjen e tij në luftën e lavdishme të UÇK-së, përkatësisht në Brigadën 128 të Zonës Operative të Pashtrikut. Sejdi Krasniqi pas luftës vazhdoi aktivitetin e tij në ngritjen e institucionit shumë vitale duke shërbyer në Zonën e Dytë të Mbrojtjes të TMK-së. Kanë qenë me qindra aktivitete të suksesshme në të cilat ai ishte pjesë. Në vitin 2009 ai vazhdoi shërbimin në FSK, me shembëlltyrën e tij prej një oficeri të sprovuar e me një personalitet shumë të formësuar. U përzgjodh si një prej oficerëve të veçantë nga Komanda e Stërvitjes dhe Doktrinës për të qenë komandant i Kompanisë së Deminimit dhe komandant i Kazermës në Prizren. Si komandant i kësaj njësie, e cila është e veçantë dhe shumë operacionale e FSK-së, u bë sinonim i suksesit dhe përkushtimit profesional e njerëzor me ushtarët e tij e me qytetarët e Prizrenit, dhe në këtë mënyrë prezantoi dhe mbrojti fuqishëm vlerat e një ushtaraku model të vendit tonë”. Në vazhdim të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi foli gjerësisht për veprimtarinë, profesionalizmin, shkathtësitë drejtuese prej eprori, aktivitetet e shumta, virtytet morale dhe njerëzore të kapiten Sejdi Krasniqit. Në fund të fjalës së tij, gjeneral Cikaqi, tha se kapiten Sejdi Krasniqi ka ofruar shumë në shërbim të vendit, FSK-së, andaj sot e kujtojmë si ushtar e mbrojtës të Lirisë, mik të veçantë, humanist dhe të palodhur në shërbim të vendit tonë”.



### Ministri dhe Komandanti ngushllojnë familjen Krasniqi!

Ministri Rrustem Berisha në telegramin e tij, dërguar familjes Krasniqi, shkruan: “E nderuar familje Krasniqi, Me keqardhje të thellë e mora lajmin për ndarjen e parakohshme nga jeta të kapiten Sejdi Krasniqit, komandant i Njësisë së Deminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së dhe veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto momente të dhembjes e të pikëllimit më lejoni t’jua përcjellë ngushëllimet e mia të thella, në emrin tim personal dhe në emër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ai, do të kujtohet përherë për kontributin e tij të madh në luftën për liri të vendit, por edhe për kontributin e jashtëzakonshëm në misionin e tij për ta bërë Kosovën një vend më të sigurt për të jetuar. Andaj, duke ruajtur kujtimin dhe respektin e përhershëm për kapiten Sejdi Krasniqin dhe mbarë familjen e respektuar, më lejoni që edhe një herë të ndaj dhimbjen me të gjithë ju”.

Po ashtu para të pranishmëve u lexua edhe telegrami i ngushëllimit për familjen Krasniqi dërguar nga Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama. “E nderuara familja Krasniqi, Në pamundësi që të jem prezent në këtë ceremoni lamtumirëse për më të dashurin tuaj, ushtarin tim dhe Komandantin e Njësisë së Deminimit, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Krasniqi. Puna dhe kontributi i kapiten Sejdi Krasniqit në të gjitha periudhat, gjatë luftës, në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe FSK janë mburrje jo vetëm për familjen por edhe farefisin. Ju si familje duhet të jeni krenarë me disiplinën, përkushtimin dhe dëshirën që kapiten Krasniqi kishte në shërbim të vendit. Në këto momente dëshiroj të përcjellë ngushëllimet e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së, duke u zotuar që punën dhe kontributin e Kapiten Krasniqit dhe të gjeneratave të tjera do ta qojmë në fund. E nderuara familje Krasniqi, në këto momente dhembjeje, kërkoj nga ju që të gjeni forcë për t’i tejkaluar ditët e vështira. Puna vetëmohuese e kapiten Sejdi Krasniqit në drejtimin e Njësisë së Deminimit ishte shumë profesionale, dëshira e tij dhe shokëve tjerë të rënë për liri shumë shpejt do të kurorëzohen me transformimin e FSK-në në Forca të Armatosura të Kosovës. Me respektin më të thellë dhe përuljen time para punës së tij, më lejoni që edhe një herë t’ju shprehë ngushëllimet tona. Prehu në paqe dhe liri për të cilën luftove dhe veprove tërë jetën”.

Ndërsa, në emër të veteranëve të luftës të Prizrenit, foli sekretari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Isa Berisha, kurse për jetën dhe veprimtarinë e kapiten Krasniqit, në emër të qytetarëve të Prizrenit, foli kryetari i Komunës Mytaher Haskuka. Në emër të familjes të gjithë të pranishmit i ka falënderuar Arbnor Sejdi Krasniqi.

Pas akademisë ceremonia është zhvendosur në Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Landovicë. Kapiten Sejdi Krasniqi, për në banesën e tij të fundit u përcoll nga Togu Ceremonial i FSK-së, pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit, të FSK-së, kolegë të tij të shumtë dhe nga familjarë. Këtu para familjarëve, pjesëtarëve të FSK-së dhe shumë qytetarëve nga anë të ndryshme të vendit, fjalën lamtumirës e ka mbajtur kolonel Shaip Haziri, komandant i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, i cili vlerësoi lart përkushtimin, profesionalizmin dhe bashkëpunimin e mirë me kapiten Sejdi Krasniqin gjatë shërbimit të tij në FSK.

Në emër të bashkëluftëtarëve dhe të Brigadës 128 të UÇK-së, foli Orhan Bislimi. Ndërsa në përfundim të kësaj ceremonie varrimi, në emër të familjes Krasniqi foli vajza e të kapiten Krasniqit, Xheneta Krasniqi.

Kohë qyqesh të qyqeve qyqe…!

# Kush shemb jetën e një nane, shemb një atdhe!



Shkruan: Riza GREIÇEVCI

Për lirinë e shtetin u derdh gjaku, paqen e shkelin...
Nuk është krenari të tregosh sa shumë i pasur je, por të kesh krenari të tregosh humanitetin, dashurinë e sojit njeri ndaj atyre që janë më të varfër se sa ti! Or ti, derdimen: Hesht, se na shurdhove sa shumë e do lirinë, por ende s'tregove sa sakrifikove dhe sa herë vdiqe për lirinë e popullit tënd! Or ti, besimtar i rremë: Na i shurdhove veshët duke kokërrzuar emrin e Zotit në çdo hap, por ende s'u pa humaniteti, besimi, dashuria, respekti i Zotit në vepër. Ma ngadalë, se na çmende, or ti, i kamur, ti që po u thua të tjerëve se vërtet e ke kapur, e ke blerë, e ke bërë lodër për interesat tua, po luan me shtetin, me drejtësinë, me ligjet, si macja me miun, dhe ti ende shet miell nga gruri i skaduar ushqim për derra të Serbisë? Liri,thua? Unë,nana, kjo që nuk jam ajo që isha dje, e mos qofsha kjo që jam sot, u thotë nana, u tregon në sy bote, para Zotit e popullit e fëmijëve: Për lirin e shtetin dhamë gjakun, paqen e shkelim, e poshtërojmë, e urrejmë edhe lirinë, e mohojmë edhe shtetin, pavarësinë... Haj medet, o pëllumbat e mi, edhe ajrin e keni të ndotur, edhe çerdhet e djegura....

### Kush po e shemb djepin, dashurinë, rritën e bebeve shqiptare?

Ka lloj-lloj fatesh në jetë. Por, fatin cub (të zi) që e përjetoi femra shqiptare në rrjedhë motesh, nuk ka shi që e lanë, nuk ka diell që e thanë. Kanuni i Maleve i tha: Darkë e dreqit! Jeta e femrës shqiptare si macja nën sofër: Tëra punët shtëpiake dhe të fushës i bëri, por së fundit sikur vendin e pati nën sofër! Haj medet! Kohë qyqesh të qyqes qyqe. Nuk iu ndal padrejtësia, punët e rënda, fjalët e hidhura, nënçmimi dhe përçmimi… Secila ditë më e zezë se tjetra. Secili muaj më i egër se tjetri. Secila stinë më e kobshme se tjetra…Sa lot me helm hidhërimi kanë pi nënat tona! Sa gjëmë kanë lëshuar. Sa mallkime kanë bërë. Sa net e net kanë qepur me vaje, me blana, me majë gjilpëre në thelb të zemrës. Por, qëndruan si Lisi qindvjeçar, të cilin sa më shumë e rrahin erërat, aq më thellë i fut rrënjët etnike Arbër. E vranë! E shanë! E dogjën!E dhunuan e përdhunuan! E poshtëruan kohët e zeza nënën shqiptare, por qëndruan dhe shemben mite e shtojzovalle, kanun e fe e mjerim e poshtërim të qenies më të bukur njerëzore me emrin: NANË! Dhe, ja kush ishin dje dhe kush janë sot nënat shqiptare, përshkruar me penë poeti: Nënat tona s`duan fishekë: sepse kanë kulla e kanë djep! Kanë ninulla, gjoks prej guri, kanë dy gjinj me qumësht biluri! Në vend buke u dhashë dashuri, u dhashë rritë e shëndet, me këta dy gjinj nane...E, ju, bijtë e mi, shembni në jetë nane? Shembni një jetë foshnjeje? Tuajat janë...

### Boll ma: Dashuri të rreme...!

Ah, Nanë, o Nanë! Ti je drita e syve. Një lot i Nanës sa ujët e krejt deteve të botës! Një uratë, një buzëqeshje e Nanës, sa floriri i tërë botës! Fjala, dashuri e Nanës 777 herë më të zjarrta se zemra e diellit! Fëmijët e botës u rroken në vallen "Dashuiria": Gjithë florinjtë që ka bota, edhe yjet me gjithë hanë, i tanë qielli, dhe krejt toka, nuk peshuakan sa një Nanë! Ju jep diellin me gjithë hanë, edhe qiellin me gjithë yje, krejt floririn që ka bota, t'gjitha i japim për një Nanë! Kush të mbushi zemrën helm? Kush të hidhëroi? Kush të lëndoi? Pjatat fluturuese, jo! As yjtë dhe hëna, jo! As dete, kroje, livadhe, jo! Ju me keni hidhëruar! Ju me sollët buzë greminës: Të jam o të mos jam! E gjallë jam, por nuk ekzistoj! Ekzistoj, por nuk jetoj! Jetoj sa për të jetuar? Me keni rrejtur. Nanën e tuaj e keni rrejtur. Me keni puthur në faqe shtatë herë në ditë. Me keni përqafuar turravrap. Para syve të Nanës jeni shfaqur engjëj. E, sot? Pse ndërruat mendje? Me dhuroni lule për Ditën e Nanave të Botës? Lule? Jo, jo lule. Asgjë. Me sillni pak dhe të vorreve...Do dërrasa dhe një qefin. Mu qorrofshin dritat e syve. M'u marrtë goja. M'u marrshin duar dhe këmbë në ua paça kujtua Nana këtë kob, këtë faqe të zezë, o bija dhe bijtë e mi. Evropa shkuli flokët. Botën e rrokën ethe. Haj medet:



### Vdiqën! Mirë bënë që vdiqën...!

Askush s'i bëri hesap mësa një pendël pule! Vdiqën, haj medet: Vdiq: Morali! Besa! Fjala! Traditat e lashta të te parëve! Vdiq dashuria. Burrëria! Askush s'hapi të pame. I tërhoqën zhargas dhe i hodhën në Shpellën e Zezë. Aty ku janë varret e bagëtive. I hodhën si një stërvinë. Askush s'u mërzit. Askush s'pyeti: E, tash? Qysh jetohet pa moral? Pa dinjitet? Pa dashuri? Shteti ynë cipricullak: Rroba e lëkurë e mushkëri ia rropën të pangopurit. Të jem o të mos jem! . E gjallë jam, por nuk ekzistoj! Ekzistoj, por nuk jetoj! Jetoj sa për të jetuar! Me keni rrejtur. Nanën e tuaj e keni rrejtur. Me keni puthur në faqe shtatë herë në ditë. Me keni përqafuar turravrap. Para syve të Nanës jeni shfaqur engjëj. Sot, me keni sjell lule? Shporrni sysh. Larg meje lulet e rreme, fjalët e rreme, dashuri e rreme, premtime të rreme....Ju jeni varfanjakët më të mëdhenj te botës! Ju jeni mashtrues... Hileqar... Hajnat, mashtruesit, shkelësit, s'kanë moral...as dashuri...as fytyrë...as dhembje për dhembjen e Nanës.

### Interesant...!

Sot askush s'merr guximin shpirtëror e mendor e moral për të protestuar: Kush e hidhëron një zemër fëmije, e helmon një shpirt nane? Kush e përmbys një djep e shemb një atdhe?! Kush e shemb një atdhe, përmbys një diell? Kush shemb një foshnje, shemb një djep, shemb gjinjtë e nanës! Kush shemb gjinjtë e nanës, shemb një diell! Kush shemb një diell, shemb njerëzimin! Kush shemb njerëzimin, shemb botën…

# Jeta e vështirë e Steve Jobs me vajzën e tij: Im at ishte koprac!



Vajza e themeluesit të Apple: në shtratin e vdekjes ai kritikoi parfumin tim. Në një libër e përshkruan atë si "koprac për para, fjalë dhe dashuri"

"Babi, këtë kompjuter Apple e ke quajtur Lisa duke menduar për mua?" "Aspak e dashura ime: kjo është një sigël që qëndron për Arkitekturën e Integruar të Sistemeve Lokale". Për një kohë të gjatë Steve Jobs e ka mohuar se i ka kushtuar një nga makinat e tij të para, një PC fatkeqe që u zëvendësua shpejt nga Macintosh, te Lisa Brennan Jobs, vajza e tij e parë. E ka pranuar shumë vite mën vonë gjatë një pushimi në vilën e Bono në Côte d'Azur, duke iu përgjigjur një pyetjeje kreut të U2.

## I vështirë me punonjësit

Brilliant dhe brutal: dritat dhe errësira e Steve Jobs, temperamentin e tij me punonjësit, e kemi treguar shumë herë. Por në aventurën e tij të përvuajtur njerëzore themeluesi i Apple ishte gjithashtu i vështirë edhe me të dashurit e tij dhe sidomos me fëmijën e parë, Lisa, e njohur me vonesë, pasi e kishte mohuar me vite që ishte babai i saj. Tani ajo, dyzet vjeç, tregon në një libër historinë e marrëdhënies së saj të trazuar me një burrë që ajo e përshkruan si "koprac me të holla, fjalë dhe dashuri". Por kjo, megjithatë, kurrë nuk e ka ndalur ta tërheqë atë me magnetizmin e saj, duke i dhënë dritë me praninë e saj. Në "Small Fry", një libër që do të publikohet brenda një muaji, por "Vanity Fair" ofron disa parashikime, Lisa ndjek kërkimin e saj të dëshpëruar për të rrëmbyer njëfarë butësie nga një baba i mërzitur, i shqetësuar dhe i dyshimtë. Ikona e gjallë e kohës sonë deri në vdekjen e tij të parakohshme (në vitin 2011 kur vdiq nga një tumor pankreatik), njeriu i cili me krijimet e tij teknologjike ndryshoi mënyrën e jetesës, vazhdon të studiohet në të gjitha pjesët e karakterit të tij. Ajo që është interesante mbi të gjitha është enigma e pazgjidhur e një karakteri të njohur për sinqeritetin brutal të gjykimit të tij, i ashpër me të tjerët dhe gjithashtu me veten në shpalljen e të vërtetave të tij të pakëndshme, por që në të njëjtën kohë mund të mohojë provat, madje edhe për vite.

## Mbajtja në distancë

Në historinë e Lizës – bijës së parë që e refuzoi, pastaj e pranoi, por gjithnjë e mbajti në një distancë që, pasi kishte studiuar në Palo Alto, në Harvard dhe në Kolegjin e Mbretit në Londër, ishte gazetare e «Vogue», revista Oprah Winfrey dhe gazeta të tjera – gjejmë të dyja të vërtetat e tij brutale dhe refuzimin kokëfortë të realitetit. Në një nga takimet e fundit, kur Steve ishte tani në shtratin e vdekjes, Lisa thotë se shkoi në banjo para se ta përshëndeste atë dhe se u shpëla në fytyrë me ujin e trëndafilave pa e kuptuar se aroma e kësaj esence natyrore do të ndryshonte në pak minuta: "U përpoqa ta përshëndes. Pastaj, kur u largova, ai më thirri: Lisa, ti mban aromën e tualetit ". Një lamtumirë e hidhur për Lisa, e cila, edhe pas njohjes, nuk ishte në gjendje të integrohej në familjen e Steve Jobs. Ai, kishte braktisur dikur shtatzënë Chrisann Brennan – partneren e tij për pesë vjet, që nga shkolla e mesme – më vonë u martua me Laurene Powell. Nga e cila – pasi kishte pretenduar të ishte steril – kishte tre fëmijë të tjerë. Kur Chrisann lindi në një fermë, Steve nuk ishte atje, por ai mbërriti tri ditë më vonë. Ai mohoi të ishte babai, por zgjodhi emrin e Lisa së bashku me nënën e saj.

## Pastruese

Krisan për dy vjet ka punuar si pastruese dhe kameriere për të rritur vajzën e saj, ndërsa Steve ka refuzuar për ta ndihmuar në çdo mënyrë. Detyruar më pas nga gjykata t'i nënshtrohet një testi gjenetik që zbuloi atësinë e tij, Steve filloi të paguajë mirëmbajtjen. Edhe pas testit gjenetik, Steve vazhdoi të mohonte provat duke u quajtur steril. Vetëm kur Lisa ishte tetë vjeç, Jobs filloi ta trajtojë atë si një vajzë. Por gjithmonë me ftohtësi. Lisa kujton se, kur një herë i kërkoi një nga makinat e tij Porsche: ajo nuk mori vetëm një mohim, por edhe fjalët "mbaje mend, kurrë nuk do të kesh gjë nga unë". Një ashpërsi ndoshta që është rezultat i boshllëqeve dhe pakënaqësive që e kanë shoqëruar jetën e themeluesit të Apple që nga lindja: i braktisur nga prindërit në të njëzetat – një studente e ëma dhe një sirian i ati, i cili më vonë u bë profesor universitar – dhe iu dha për adoptim Jobs-ave, në një familje të përulur nga origjina.

*(gazeta-Shqip.com)*

# Policia gjen prova për vrasjen e XXXTentacion



Kërkimi i një veture "Cadillac" në pronësi të gjyshes së njërit prej të dyshuarve për vrasjen e XXXTentacion, emri i të cilit është Jahseh Onfroy, ka treguar prova të rëndësishme. Sipas "TMZ"-së, policia ka gjetur dy maska të zeza, të njëjta me ato që vrasësit kishin vendosur natën e sulmit. Gjithashtu, në këtë veturë është gjetur një sasi e konsiderueshme e plumbave, të njëjtë me gëzhojat që janë gjetur në vendin e krimit. Katër të dyshuarit për vrasjen e reperit janë të arrestuar dhe po përballen me akuza për vrasje të shkallës së parë dhe bashkëpunim.



# Jennifer Lopezi nis pushimet luksoze me të dashurin Alex Rodriguez

Shumë nga të famshmit këtë vit zgjodhën Italinë si destinacionin e tyre për pushime. Edhe këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, kaloi disa ditë me të dashurin në brigjet e Sardenias. Së fundmi, plazhin italian kanë zgjedhur edhe këngëtarja e famshme, Jennifer Lopez, me të dashurin e saj, Alex Rodriguez. Çifti janë parë duke u relaksuar në një ishull italian teksa shëtitshin me jahtin e tyre luksoz.

# Selenës i mungon Justin Bieberi?



Justin Bieberi zyrtarisht i dha fund mundësisë së bashkimit me Selena Gomezin kur u fejua me modeluesen Hailey Baldwin. Përderisa këngëtarja 26-vjeçare po e shijon jetën si beqare, duket se nuk e ka harruar tërësisht Justinin. "Selena është tejet e zënë pune dhe është e lumtur, megjithatë ka momente kur i mungon Justini. Bëhet fjalë për dikë që e ka dashur me vite të tera dhe natyrisht se ka emocione. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që ka gjasë për ndonjë ribashkim", ka thënë një burim i afërt me bukuroshen për "Hollywood Life". Justin dhe Hailey ishin në lidhje për një kohë të shkurtër para se këngëtari t'i propozonte në Bahamas muaj më parë.

# Pennant fshehu krimin e bërë nga qeni i tij



Ish e dashura e Jermaine Pennant, aktorja Jennifer Metcalfe, kishte menduar se macja e saj ishte zhdukur dhe për shumë kohë e kishte kërkuar. Se çfarë në të vërtetë ndodhi me të e dinte saktësisht Pennant, por kishte heshtur për shkak që nuk kishte dashur ta shqetësonte personin e tij të zemrës. Ky sekret doli pas publikimit të autobiografisë së ish-futbollistit të Liverpoolit, i cili zbuloi se ishte pikërisht qeni i tij Akita ai që e kishte kthyer shtëpinë e tyre në një skenë të filmave horrorë. "Kishte gjak në të gjitha anët, në qilim, në mure, në gardh. Ishte një skenë me të vërtetë e tmerrshme dhe shqetësuese", ka thënë Pennant.

Autor: GAZMEND MORINA

KËNGËTARJA & AKTORJA NË FOTO 2

ANIJATË; PJESË E BRENDSHME E NJË KISHE (shq.)

UDHËHEQËS I NJË FAKULTETI / MËNDESHË, TAJË

TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN

TAKSË

ZANORE

RENS ISTVUD

MENDIMET

NGADHËNJIM NË NJË LOJË

QË I KA RËNË TË FIKËT; I .........



1

KËNGËTARJA DHE MODERATORJA NË FOTO 1

I ZË ME DORË

MEKANIZËM I THJESHTË, QË SHËRBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE

JETË PA TRAZIME (shq.) / ISH PRESIDENTI SHQIPTAR RAMIZ ....

I UJITA

I MORALSHËM / FUTBOLLISTI FRANCEZ TIERI ....

ANALISTI SHQIPTAR MUSTAFA

I GDHENDA E THAVA

ELIZABETH TAYLOR

LËNDË MËSIMORE

REGJISORI HALILI / GRUMBULLIM (sh.shq.)

ZHANËR I MUZIKËS (origj.) / KRYEQYTETI I AZERBAJXHANI

FUQI, FORCË

POLITIKANI SHQIPTAR IMAMI / RIFAT AVDIU

PEIZAZHI I GJERË

ZANORE

PORTIERI KASILLAS / METAFORA E GJATË

INDIA, ARMENIA / PJESË E KËMISHËS (sh.shq.)

ORHAN PUNAJ / ZANORE

FATALIZËM

AKTORJA ITALIANE BELLUÇI / MOSHË E RE

TRANSFER MULTISORT ELEKTRONI

ZANORE

KALORËS JAPONEZ

ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA / ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI

TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROLOGJIKE

LETËR E FORTË NË BIXHOZ / BASHKËTING.

I NJËZËSHËM / DY BASHKËTINGËLLORE

SEKTË I VEÇANTË I MYSLIMANËVE

AGJENCIA EVROPIANE

ZANORE / INDIUM, ELEKTRON

MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË / INTENSITET, TITAN

KËPUCË ME RROTULLA PËR TË RRËSHQITUR / HOLLË, JO TRASHË

KËNGËTARE E JONA / GRUP MUZIKOR

EMËR MASHKULLI MYSLIMAN / SHKRONJË GREKE

PIJE ALKOOLIKE QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSHIT / KLINT ISTVUD

ZANORE / EKZEMPLAR I VETËM

AFTËSI E PAGIMIT (treg.)

BASHKËTING. / FIGURË SHAHU

FORTESË / AKTORI MUÇAJ

"URUGUAI" / PRINCIPATË ARABE (sh.shq.)

MURG I VETMUAR

MASË NDËSHKIMORE (shq.) / PASION PËR T'U VËNË ZJARRIN OBJEKTEVE

KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI / OHAJO, PENSILVANIA

NORA ISTREFI

ZANORE / BASHKËTING.

PANDJESI, LIMONTI / EVERTON

NUKLEAR / NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT (shq.)

SHKRIMTARI ALIGHIERI

ISLANDA, MALTA / FEMRA LUFTËTARE (mit. greke.)

MARC ANTHONY / E VËNGËR (sh.shq.)

GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE / REGJISORI QOSJA

2



LLOJ GËLQERORI

RADIUM, TON / SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.)

"MOLDE" / BANJË ALLATURKA (vjet.)

FUTBOLLISTI FETAHU / EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN (shq.)

PËRFUNDIM NË SHAH / FUTBOLLISTI ARGJENTINAS JUAN SEBASTIAN

LLOJ BUKE

TEPSI BALTE (sh.shq.) / HISTORIANI ROMAK LUKRECI

BASHKËTING. / TINARI

MJESHTËRIA, PROFESIONI

PARA TË NËNTËS / GURRA

MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT

PUNIM I ARËS

BEREQET (krah.)

KOHË / BASHKËTING.

"RUANDA" / BASHKËTING.

ANDORA

ISMET TOTO

STADIUMI I KLUBIT MILAN "... SIRO"

NDËRTESË PRANË UDHËS QË SHËRBENTE SI BUJTINË

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: D, ENEDA TARIFA, MAKARA, IDILI, I VADITA, ETIK, NANO, I LATOVA, ET, EMIN, RAP, TAKAT, ARBEN, O, IKER, IA, OP, SAMURAJ, KASAFORTA, KLIMA, ATU, UNANIM, AE, U, SKI, TROTINET, GILI, AMIR, RAKI, A, BONITET, M, KALA, UR, EREMIT, DËNIMI, ENI, NI, E, APATI, ATOMIK, DANTE, IM, MA, EPIKA, ARAGONIT, RAT, MO, ENIS, PAT, HAMAM, TAVAT, S, ZANATI, E TETA, ONANI, ARATIM, NIMET, MOT, RU, A, IT, SAN, HAN.

E jashtëzakonshme

# Në Holandë rrugët riemërohen me emra të femrave




Disa rrugë në Holandë po riemërohen jozyrtarisht nga aktivistët, në nderim të grave të respektuara, pasi një studim ka treguar se 88 për qind e rrugëve në qytetet e mëdha mbajnë emra meshkujsh. Tabela që mbajnë emrat e femrave luftëtare, matematikaneve, shkrimtareve apo muzikanteve po vendosen nëpër rrugë nga grupi feminist "De Bovengrondse", që do të thotë "tokësore" (apo mbi tokë).

FOTO E DITES



Një zhytje e pinguinëve në kopshtin zoologjik në Frankfurt të Gjermanisë. /AP/

E rrallë

# Shuhet Frankie, qeni që nuhaste tumorin e tiroideve




"Asnjëherë mos gjyko një libër nga kopertina". Kështu, një shkencëtar ka dashur të kujtojë Frankien, qenin shkencëtar i bërë i famshëm në ShBA për shkathtësinë e tij të jashtëzakonshme në fushën mjekësore, atë të diagnostikimit të tumorit të tiroideve, thjesht duke nuhatur urinën e pacientëve.

## BARSOLETA E DITËS



**Kur e çoj nëpër mend se gruaja do të kthehet pas një muaji nga pushimet me zënë ethet.**
**- E sa kohë ka që ka shkuar për pushime gruaja juaj?**
**- Ah ç'ia fut kot edhe ti! Ajo është ende në shtëpi. Pasnesër do të niset.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed






Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të jetë ditë e qetë dhe me plot harmoni me personat që ju qëndrojnë pranë. Nuk mërziteni nga askush dhe u ktheni përgjigje të gjithëve që kanë pyetje.



**DEMI**
Pasi të keni vendosur objektivat tuaja, do të filloni të vepronì. Nuk do ta keni të lehtë t'i mposhtni disa pengesa të papritura.



**BINJAKËT**
Keni ditur të zgjidhni më të mirën nga miqtë tuaj. Edhe ju duhet të jeni më aktiv në punët që keni para vetes.



**GAFORRJA**
Gjërat e vogla janë ato që do ta bëjnë lumturinë tuaj sot. Partneri është bashkudhëtari juaj në ëndrrën për të ardhmen së bashku.



**LUANI**
Ato që thuhen në momentin e gabuar, mund të prekin njerëz që për ju janë vërtet të rëndësishëm. Sot do të pendoheni për një fjalë të thënë.



**VIRGJËRESHA**
Do t'ju duhet të jeni mjaft të programuar sot. Punët dhe agjenda e ngarkuar që keni, nuk do t'ju lënë asnjë çast të lirë për t'u çlodhur.



**PESHORJA**
Një ditë e zhurmshme kjo e sotmja e karakterizuar nga humori dhe të qeshura pa fund. Familja është streha juaj e ngrohtë në çdo çast.



**AKREPI**
Arti dhe muzika janë ato që do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës. Sot do të ecni me zemër dhe jo me arsye.



**SHIGJETARI**
Sot po shpresoni të mos keni vizita të paprogramuara, por do të ndodhë krejt e kundërta. Do t'ju ngatërrohen situatat dhe personat.



**BRICJAPI**
Biznesi dhe marrëveshjet janë pika juaj e fort sot. Do t'ju kërkojnë ndihmë dhe do të dini të jepni atë që do t'ju kërkohet pa shumë probleme.



**UJORI**
Entuziazmi juaj që fillon në orët e para të mëngjesit do të l'i pa fjalë bashkëpunëtoret tuaj.



**PESHQIT**
Sot jeni aq komod sa nuk keni aspak dëshirë të reagoni apo të vendosni. Do të lini gjithçka në dorë të të tjerëve dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | BOURNEMOUTH - CARDIFF | 2 | HUDDERSFIELD - CHELSEA | 2 | WATFORD - BRIGHTON | GG |

# Ademi: Ejani në përurimin e stadiumit 'Fadil Vokrri'

Stadiumi "Fadil Vokrri" do të përurohet të hënën me ndeshjen e Superkupës së Kosovës në mes të Prishtinës dhe Dritës, kurse kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka bërë thirrje që sa më shumë qytetarë të jenë të pranishëm për ta parë mrekullinë që është bërë në këtë impiant futbolli

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka ftuar qytetarët të jenë të pranishëm në numër sa më të madh në përurimin e stadiumit "Fadil Vokrri". Ndeshja përuruese do të jetë finalja e Superkupës në mes të Prishtinës dhe Dritës nga Gjilani, e cila zhvillohet të hënën nga ora 20:00. Ademi ka bërë me dije se nëse inspektorët e UEFA-s do ta japin dritën e gjelbër, atëherë certifikata e pranimit do t'i dorëzohet Komunës së Prishtinës. "Kjo është një ndeshje testuese dhe do të organizohet sikur të ishte ndeshje ndërkombëtare. U bëj thirrje qytetarëve të jenë në numër sa më të madh në stadium, pasi do të kenë mundësi ta shohin tërë atë mrekulli që është bërë në stadium dhe do të jenë tepër komodë për ta kaluar një mbrëmje afër futbollit. Në këtë ndeshje do të bëhet testimi nga inspektorët e UEFA-s, të cilët më pas, nëse jepet drita e gjelbër, do të dorëzojnë edhe certifikata tek pronari i stadiumit që është Komuna e Prishtinës", ka thënë Ademi, i cili e ka falënderuar Ministrinë e Sportit dhe ministrin Kujtim Gashi, punëkryerësin 'Al Trade', UEFA-n e cila ka qenë krah i fortë i FFK-së në realizimin e këtij projekti. Më pas Ademi ka falënderuar edhe kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, për propozimin që ky stadium ta bartë emrin e ish-presidentit të FFK-së dhe legjendës së futbollit, Fadil Vokrri, si dhe Asamblenë Komunale që e ka votuar unanimisht propozimin e tij.



